

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



Shoqat

*Fladi*

Autori : Sejid Muhamed Ibraim Kazvini

# MBULIMI



lunturi jo fatkeqësi

Përkthyesi: Vullnet Merja

*Shoqëria  
Flladi*

Tiranë 2005

**Titulli: Mbulimi lunturi jo fatkeqësi**

**Autori : Sejid Muhamed Ibrahim Kazvini**

**Përkthyeu: Vullnet Merja**



**Korrektori: Vjollca Feza**

**Kompjuteri: Sabrie Feza**

*Shogqata*  
*Flladi*

# Parathënie

Me emrin e Allahut Mëshiruesit Mëshirbërësit

Falenderimet i takojnë Allahut, Krijuesit të gjithësisë. Paqja, bekimi dhe mëshira e Tij qofshin për zotninë e të gjithë njerëzisë dhe më të përsosurin e Profetëve dhe të dërguarve, Profetin Muhammed (s.a.s), për familjen e tij të nderuar dhe për shokët e tij të zgjedhur.

Një prej kërkimeve studimore të kësaj kohe, është “Hixhabi” (*mbulimi*), dhe kuptimi i gabuar rreth tij, për të cilin shumë njerëz përpiqen për ta mbjellë këtë kuptim të gabuar në shoqërinë tonë Islame.

Nuk ka dyshim se femra përbën më tepër se gjysmën e shoqërisë dhe se për atë ndodhen respekte dhe nderime si çdo njeri i cili jeton në këtë planet. Gruaja, nuk është krijesë e panjohur në këtë botë dhe as element i jashtëm i kësaj jete, përkundrazi, ajo është partenere e jetës.

Përderisa Islami është fe e kësaj jete, Ai i ka dhënë përparësi kujdesit për gruan duke vendosur rregulla dhe ligje të drejta për çdo anë të jetës së saj, qoftë kjo jetë personale, bashkëshortore, familjare apo shoqërore.

Për këtë, në Kur`an ndodhet një sure e plotë, e cila mban emrin “En- Nisa” (*grua*). Po ashtu, Kur`ani Famëlartë përmban ajete të shumta, të cilat flasin rreth gruas, për rregullat të cilat kanë lidhje me të, për ligjet të cilat i japin asaj mirësi, harmoni dhe i sigurojnë lumturi në këtë jetë dhe në jetën tjetër (*Ahireti*).

Përderisa natyra e gruas, përta i përket anës fiziologjike, shpirtërore, shoqërore e të tjera..., ndryshon nga ajo e burrit, është e natyrshme që të ketë dallime në mes burrit dhe gruas në disa ligje dhe rregulla. Ky dallim, - i cili nuk ka ardhur veçse, në përputhje me gjendjen shpirtërore dhe natyrën e gruas, - nuk ka për qëllim mangësinë e saj, siç e akuzuan kundërshtarët e Islamit, Islamin për këtë çështje.

...Dhe erdhi ligji i hixhabit (*mbulimit*), i cili është në krye të ligjeve të shariatit, të cilin Islami e vendosi atë dhe e bëri obligues për gruan për t'i siguruar asaj lumturinë dhe për t'i mbrojtur nderin.

Domosdoshmërinë e mbulimit e shohim në ajetet e Kur'anit, në të cilin, Allahu (xh.sh) e përmend këtë ligj në disa ajete dhe jo në një ajet të vetëm, siç janë disa ligje dhe rregulla, të cilat Allahu i përmend me një ajet të plotë, apo me një fragment të ajetit.

Kjo përsëritje dhe kjo dëshmi e Allahut (xh.sh), tregon se sa i domosdoshëm është mbulimi për gruan në këtë jetë.

Ajo, e cila tërheq vëmendjen dhe fton në përkujdesje është, se ligji i mbulimit, gjithmonë është në ballafaqim me shumë sulme dhe kundërshtime prej kundërshtarëve të Islamit si dhe ftuesit e fesadit dhe çrregullimit, deri sa u bë pike shënjestre i lapsave dhe trumbetave të tyre.

Ata, filluan ta përytyrojnë gruan duke e cilësuar atë si të prapambetur e duke thënë se Hixhabi është mjerim dhe fatkeqësi për gruan, mangësi për atë në këtë jetë,... e shumë e shumë akuza dhe shpifje të ngjyrave të ndryshme.

Është për të të ardhur keq kur shikon shtete të cilët mbajnë një qëndrim negativ ndaj Hixhabit dhe përdorin të gjitha mundësitë e tyre për përhapjen e mendimeve rreth mosmbulimit të gruas si dhe zgjerimin e këtij mendimi në mesin e grave muslimane.

Në çdo kohë, lexojmë në gazeta, apo dëgjojmë në lajme se iks (x) shtet nxorri ligjin për ndalimin e vajzave të mbuluara në vazhdimësinë e mësimeve të tyre në shkolla të mesme, apo në universitete dhe se shteti tjetër ka vendosur si kusht kryesor mosmbulimin për studentet,... etj!!

Nëse kthehesh pak prapa në historinë e Iranit, p.sh, do të lexosh se qeveria në fillim të periudhës Mbretërore nxorri ligjin zyrtar për ndalimin rreptësisht të Hixhabit në të gjitha anët dhe krahinat e qyteveve. Ajo, shpërndau punonjësit e rendit nëpër rrugë dhe nëpër tregje, për t'u hequr shamitë grave të mbuluara, me qëllim të «zhdukjes» së Hixhabit,.

Prej këtij veprimi, gratë besimtare e panë të arsyeshme që të qëndrojnë në shtëpitë e tyre dhe të mos dalin prej tyre për disa vite, nga frika që punonjësit e rendit dhe policia të mos i zbulonte ato.

Vallë..., përse kjo luftë e ashpër kundër Hixhabit?

Përse nuk e luftojnë drogën helmuese, e cila shkatërron shoqëri të tëra dhe asgjeson shpirtëra të shumtë?!

Allahu (xh.sh) thotë: **{Dhe kur kthehet, ai vepron vepra shkatarruese në tokë, të asgjesojë të mbjellat dhe gjallesat. E Allahu nuk e don çrregulimin}**<sup>(1)</sup>.

Po! ... Ata, vërtet e kuptuan urtësinë e këtij ligji dhe filozofinë e tij llogjike, natyrore, ndikimet pozitive të tij dhe vunë re, se Hixhabi është një fortifikatë ndaluese përballë planeve dhe thënieve të tyre kundër shoqërisë së pastër islame.

Nga këtu..., ata e luftojnë këtë ligj të islamit me mënyra të ndryshme, nëpërmjet programëve televizive, qendrave të

---

(1 ) Sure Bekare ajeti 205

infomacionit, gazetave, revistave, kinemave etj... dhe përpiqen për zhveshjen e mbulesave të grave muslimane si dhe heqjen e shamiave të tyre. Ata përpiqen në shtytjen e tyre për në prehërin e degjenerimit dhe të imoralitetit.

Përderisa çështja është e tillë, është detyrë për çdo grua muslimane, që të intersohet për hixhabin, dhe, pikërisht ajo duhet të luajë një rrol të madh në përhapjen e rrugës së këtij ligji hyjnor në mesin e studenteve, vajzave, zonjave dhe t'i ftojë ato në zbatimin e këtij ligji begatues.

Është obligim për gruan muslimane në veçanti dhe për të gjithë muslimanët në përgjithësi, që të mos i lënë vend armikut për realizimin dhe praktikimin e ideve të tyre djallëzore, të cilat janë dëmtuese për Islamin dhe shoqërinë islame.

Shpresojmë, që ky libër të jetë një hap i rëndësishëm në këtë drejtim. Vërtet, Allahu është Mbarësues dhe Mbrojtës.

Muhamed Ibrahim Muvahid.

### **Kur'ani është vërtetues i hixhabit**

Kur'ani Fisnik, Kushtetuta hyjnore për mbarë njerëzinë, e konstaton hixhabin në disa ajete. Ndër to, po përmendim disa prej atyre ajeteve, me një zbërthim përmbledhës.

Allahu (xh.sh) thotë: **{O Pejamber, thuaji grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le të vejnë shamitë (mbulojnë) mbi trupin tyre, sepse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen. Allahu i fal gabimet e kaluara, Ai është Mëshirues}**. Sure Ahzab, 60.

Në këtë ajet Allahu (xh.sh) i thotë të dërguarit të Tij, Muhamedit (s.a.s), që t'i urdhërojë gratë muslimane, duke filluar me gratë e Tij, vajzat e Tij dhe gratë e besimtarëve që të mbulohen.

Disa komentues kanë përmendur se shkak i zbritjes së këtij ajeti është, se gratë shkonin tek xhamia e Profetit Muhamed (s.a.s) për të falur namazet me xhemat (*grumbullim*). Kur shkonin për të falur akshamin dhe jacinë, djemtë që rrinin në rrugë i ofendonin dhe i kërcënonin ato. Në këtë kohë, zbriti ajeti, i cili i thotë Profetit që t'i urdhërojë gratë që të mbulohen dhe të vendosin shamitë me qëllim që askush të mos i kërcënojë e të mos i ofendojë ato.

1- Allahu (xh.sh) thotë: **{O Pejgamber thuaji grave tuaja, vajzave tuaja dhe grave të besimtarëve le të vejnë shamitë}**.

Shiko këtë të vërtetë hyjnore ku Allahu (xh.sh) nuk ka thënë: «thuaj grave», ku dihet se kjo shprehje i përmbledh gratë e Profetit dhe vajzat e Tij, por, Ai (xh.sh) ka thënë: «*Thuaj: a - Grave Tuaja, b - Vajzave Tuaja, c - Grave të besimtarëve...*»

Kjo na udhëzon në domosdoshmërinë e hixhabit dhe, se është detyrë për familjen e Profetit (s.a.s) që të intersohen më tepër për këtë ligj hyjnor e të begatë.

Pastaj Allahu (xh.sh) thotë: **{le të vejnë shamitë (mbulojnë) e veta mbi trupin e tyre}**.

Allahu (xh.sh) e urdhëron gruan që të mbulohet dhe të mbrojë bukurinë, të cilën Ai (xh.sh) ia ka dhënë asaj.

Ndoshta një grua është e mbuluar, por ky mbulim mund të jetë jo i plotë, siç shohim shumë prej tyre, ku, p.sh, ajo ka veshur fustan të gjatë, por fytyra e saj është e zbuluar, flokët dhe qafa e saj janë të dukshme.



Sigurisht, ky lloj mbulimi nuk e vërteton atë qëllim të Allahut (xh.sh), sepse, Ai (xh.sh) thotë: **{le të vejnë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre}**.

Për gruan muslimane, është obligim që t'i bindet dhe t'i përulet Allahut, Krijuesit të saj të Urtë e Fuqiptotë dhe të mbulohet me atë mbulim, i cili i siguron asaj ndershmerinë, pastërtinë, shëndetin dhe sigurinë prej të ligëve.

Më poshtë, Allahu (xh.sh) thotë: **{sepse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe)}**, sepse, mbulimi i krijon gruas dëgjim të pastër në njerëz dhe njihet me ndershmeri e riformim në shoqëri.

**{dhe nuk ofendohen..}** prej askërkujt, sepse, hixhabi e mbron gruan prej lakmive të të ligëve dhe keqbërësve dhe se bukuria e saj është e mbuluar dhe nuk dallohet asgjë prej saj.

Është e natyrshme se devijuesit e të gjitha kohërave i ofendojnë apo i kërcënojnë ato femra të cilat janë të zbukuruara dhe bukuria e tyre është e dukshme, ndërsa kur ajo është e mbuluar i shtururi e di se ajo grua është mbrojtëse e bukurive dhe e nderit të saj dhe nuk i bën keq asaj, sepse ai e din se ajo nuk përputhet me të, por jo vetëm kaq se ndoshta ajo do t'i flasë atij me zë të lartë dhe do ta skandalizojë në sy të njerëzve.

### **Përmbledhje:**

Ky ajet i Kur'anit përmban një argument të qartë mbi vaxhibin (*detyrim*) e mbulimit dhe se ky mbulim e mbron gruan prej degjenerimitit dhe prej keqbërësve e të ligëve.

2 - Allahu (xh.sh) në Kur'an thotë: **{Nëse kërkoni ndonjë send prej tyre (grave), kërkoheni atë pas perdes, kjo është**

**më e pastër për zemrat tuaja dhe për zemrat e tyre}**. Sure Ahzab, 54.

Në këtë ajet të bekuar Allahu (xh.sh) i urdhëron muslimanët se, nëqoftëse ata kërkojnë ndonjë send prej grave të Profetit (s.a.s), ta kërkojnë pas perdes. Ndërsa, fukahatë (*teologët*) dhe komentuesit e Kur'anit thonë se ky ligj nuk është i posaçëm vetëm për gratë e Profetit (s.a.s), por ky ligj është i përgjithshëm për të gjitha gratë dhe për të gjitha kohërat.

Pastaj, Allahu (xh.sh) thotë se pyetja pas perdes, {**...është më e pastër për zemrat tuaja dhe për zemrat e tyre (grave)**}. Pra, perdeja është pastërti dhe mirësi si për burrin ashtu edhe për gruan.

Përsa i përket burrit, sepse, shikimi i tij tek gruaja ndikon në epshet seksuale dhe djalli përfiton në këto momente duke e shtyrë atë në drejtim të Haramit (*ndaluara*) dhe imoralitetit.

Ndërsa përsa i përket gruas, mosmbulimi i saj e bën nderin dhe pastërtinë të ndeshen me rreziqe dhe kërcënime të shumëllojshme.

Pra, hixhabi është pastërti për burrat dhe për gratë njëkohësisht.

Nga ky ajet përfitohet dobia se përzierja në mes dy gjinive çon në çrregullim, siç ndodh tek ato shoqëri në të cilat praktikohet përzierja në mes burrave e grave dhe aq më keq kur ato janë të pambuluara dhe shfaqëse të bukurive të tyre.

Allahu (xh.sh) e ka bërë të ndaluar shkatarrimin me të gjitha llojet dhe ngjyrat e tij.

Këtu lind pyetja: Përse Allahu i drejtoi fjalët për gratë e Profetit (s.a.s)?

Përgjigje: Kjo, për shkak të pozitës së tyre në shoqëri, sepse, ato janë nënat e besimtarëve dhe prej tyre kërkohet që të jenë më tepër obliguese në zbatimin e ligjeve të Allahut (xh.sh), e prej atyre ligjeve të rëndësishme është edhe ai i mbulimit. Për këtë, Allahu (xh.sh) në fillim të ajetit thotë: **{O gratë e Pegjamerit, ju nuk jeni si asnjë grua tjetër...}** sure Ahzab,31. Kjo është e njëjtë sikur t'i thuash një personi të kulturuar: O njeri i kulturuar, ti nuk gënjen.

Kjo nuk ka kuptimin se gënjeshtria është e lejuar për të tjerët, por, kjo ka kuptimin se e vërteta është më e obliguar për ty, ndërsa, gënjeshtria është gjëja më e keqe për ty.

Gratë muslimane shkonin tek bashkëshortet e Profetit dhe mësonin prej veprimeve të tyre, prandaj, ishte e domosdoshme prej grave të Profetit që të mbanin më tepër përgjegjësi për urdhërat e Allahut.

3 - Allahu (xh.sh) thotë: **{... Dhe rrini në shtëpitë tuaja dhe mos shfaqni bukuritë tuaja si shfaqej në injorancën e hershme...}**

Allahu (xh.sh) kërkon prej gruas të qëndrojë në shtëpinë e saj me qëllim që të drejtojë nevojat e brendshme të saj siç janë ato bashkëshortore, familjare dhe të jetë e lirë për edukimin e fëmijëve të saj me edukatë të pëlqyer e të pastër, dhe ti rrisë ata me fe dhe me morale. Pastaj Allahu (xh.sh) e urdhëron që të mbulohet dhe të mos i shfaqë bukuritë e saj duke thënë: **{... mos shfaqni bukuritë tuaja si shfaqej në injorancën e hershme}**. Pra, mos dilni prej shtëpive tuaja të zbuluara dhe të zbukuruara siç vepronin gratë në kohën para Islamit, sepse, zbukurimi ka kuptimin që: Gruaja të shfaqë bukuritë e saj para burrave të panjohur, për këtë gjë Allahu e ndaloi zbukurimin jashtë shtëpie dhe e ka bërë haram.

Në këtë ajet të bekuar përfitojmë se Allahu (xh.sh) kërkon që gruaja muslimane të dallohet nga gratë e tjera me mbulim dhe me virtyte, sepse, gratë jahudite (*hebrejtë*) dhe ato krishtere, nuk e besojnë këtë ligj të sheriatit islam dhe as nuk e zbatojnë atë, por ato dalin të zbukuruara e të pa mbuluara. Allahu (xh.sh) nuk e pranon këtë zbulim dhe këtë zbulurim prej grave muslimane, por dëshiron që ato të jetojnë të lumtura e të respektuara në atë shoqëri që jetojnë.

Ajo grua muslimane, e cila nuk zbaton ligjin e mbulimit dhe zgjedh zbulimin, kjo do të thotë se, ajo u përngjan grave jahudite, krishtere dhe idhujtareve të tjera të cilat nuk adhurojnë Zotin (xh.sh).

Në një hadith thuhet: Allahu i tha një të dërguari prej të dërguarave të Tij: *«U thuaj besimtarëve: Mos vishni rrobat e armiqëve të Mi, mos ushqeheni me ushqimet e armiqëve të Mi dhe mos ecni në vijën e armiqëve të Mi, sepse, do të jeni armiq të Mi ashtu siç janë ata»*<sup>(2)</sup>.

Ky hadith, edhe pse në fillim përmend besimtarët, por ai është përmbledhës edhe për besimtarët, siç shohim në shumë ajete të Kur'anit dhe hadithe të Profetit (s.a.s).

Këto tre ajete, kanë zbritur për hixhabin (*mbulimin*). Po ashtu, në Kur'an ndodhen ajete të tjera rreth kësaj të vërtete të cilat nuk i kemi përmendur, sepse, qëllimi ynë është të paraqesim në mënyrë përmbledhëse këtë subjekt.

---

(2 ) Kitab Tehful Ukul.

## Fatime Zahra

Zonja Fatime Zahra, është gruaja simbol në Islam, si dhe për çdo grua e cila kërkon të jetojë e lumtur në këtë jetë.

Ajo është zonja e të gjitha grave të botës, e cila arriti në majat më të lart të famës, derisa Profeti (s.a.s) për të ka thënë:

*«Allahu e don atë që e don Fatimenë dhe e urren atë që urren Fatimen».*

Është obligim për të gjitha gratë e botës që, këtë zonjë të famshme ta marrin shembull në jetën e tyre, të ndriçohen me dritën e saj shkëlqyese, të ecin në udhën e saj e cila është ruga e shpëtimit dhe e lumturisë.

Zonja Fatime është shembulli i të gjitha virtyteve dhe mirësive, ku çdo grua, e cila ecën në udhën e Fatimesë do të lumturohet dhe çdo grua e cila nuk ndjek udhën e Fatimesë do të jetojë në mjerim dhe fatkeqësi.

Kjo zonjë e lartë ka qenë në pozitat më të larta të hixhabit dhe pastërtisë. Kur dilte prej shtëpisë së saj ajo dilte e mbuluar nga koka e deri tek këmbët. Ajo e përbuzte në

mënyrë të rreptë zbulimin dhe mosbulimin, kjo përshkak se edhe Allahu i përbuz këto veprime dhe se zbulimi është çelësi i të këqijave, udha për në imoralitet dhe parapërgatitje për degjenerimim.

Dhe tani, ejani të lexojmë disa mësimë të hixhabit dhe virtytit të jetës së Fatimesë:

### **Ç'është e mirë për gruan?**

Në histori thuhet se: Profeti (s.a.s) i`u drejtua shokëve të Tij dhe i pyeti:

*«Cila është gjëja më e mirë për gruan?»*

Shokët e Tij heshtën, sepse, ata nuk e dinin me saktësi përgjigjen rreth kësaj pyetje. Ai (s.a.s) i`u drejtua atyre përsëri duke u thënë: *cila është gjëja më e mirë për gruan? Pasuria? Bukuria? Martesa? Cila ?* Më këto fjalë Profeti (s.a.s) sikur kërkonte mendimet e tyre.

Zonja Fatime kur dëgjoi për këtë pyetje, dërgoi një person tek babai i saj që t`i thotë Atij : *“Më e mira për gruan është që ajo të mos shohi burrat dhe as burrat të mos e shohin atë (sigurisht fjala është për burrat e huaj).* Shokët qëndruan në pritje se çfarë do të thonte Profeti (s.a.s) rreth përgjigjes së vajzës së tij fisnike!

Profeti (s.a.s) tha : *Ajo ka të drejtë... Fatimeja është pjesë e trupit Tim<sup>(3)</sup>.* Pra, përgjigja e saj e ka burimin në të vërtetën e sinqertë dhe prej besimit real.

---

(3 ) Mustedrek el vesail: Libri i martesës, Biharul Envar: V.103 F.238.

Me këtë përgjigje Profeti u drejtohet të gjitha grave të botës se mirësia e gruas ndodhet tek hixhabi dhe fatkeqësia e saj ndodhet tek zbulimi.

### **Dialog i shkëlqyer**

Në histori thuhet:

Zonja e lartë, Fatime Zahra, një ditë ndodhej tek shtëpia e babait të saj, Profetit Muhamed (s.a.s).

Në atë kohë Ibën Um Mektum kërkoi leje për t`u takuar me Profetin. Ky person ishte i verbër dhe nuk shikonte. Para se të hynte Fatimeja u çua dhe u largua nga dhoma.

Kur Ibën Um Mektum u largua, Fatimeja u kthye dhe hyri në dhomën e babait të saj për të dytën herë. Profeti (s.a.s) e pyeti atë rreth shkakut të daljes së saj nga dhoma ku dihej se Ibën Um Mektum nuk shikonte. Ai (s.a.s) e dinte këtë gjë, por deshi që ajo (Fatimeja) t`i përgjigjej kësaj pyetje dhe historia ta shkruajë këtë dialog i cili e ka burimin në besimin e pastër dhe të lartë, ku ky dialog të mbetet shembull i gjallë për të gjitha kohërat.

Ajo tha: “ *Nëse ai nuk më shikon mua, unë e shikoj atë, dhe ai e ndien erën e gruas*”.

Profetit (s.a.s) i pëlqeu kjo përgjigje e vajzës së Tij fisnike dhe nuk e qortoi për këtë obligim të rreptë mbi hixhabin, por Ai i dha asaj kurajo më tepër dhe i tha: “*Unë dëshmoj se ti vërtet je pjesë prej meje...*”

## Në Xhaminë e Profetit

Kur Fatimeja mbajti hytbe në xhaminë e Profetit (s.a.s) atë hytbe historike dhe të pa harrueshme, asaj i vendosën perde në xhami. Ajo me gratë u ulën në një anë dhe burrat, të cilët ishin prej Muhaxhirëve (*emigrantët*) dhe Ensarëve (*përkrahësit*) u ulën në anën tjetër.

Kjo perde përmban disa kuptime dhe ndër ato janë:

- Ajo është zbatimi i ligjit të hixhabit ku ai është ndarës në mes burrave dhe grave.

- Ajo ndalon praktikimin e përzierjes në mes meshkujve dhe femrave, për të cilën ftojnë kundërshtarët e islamit si dhe thërrasin për të misionarët devijues e të humbur.

Pas asaj perdeje Zonja Fatimeja filloi të predikojë atë hytbe të mrekullueshme, përsa i përket diturisë, urtësisë, kuptimeve të larta, etj.

Duhet që çdo musliman dhe muslimane ta lexojë atë hytbe, të mendohet në paragrafet dhe shprehjet e saj, me qëllim që atyre t'u hapen horizontet e gjëra në qiellin e diturisë dhe imanit.

O motra muslimane: Këto janë tre shembuj prej zonjës së grave të botës dhe gruas shembëllyese në Islam, Zonja Fatime Zahra (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin për atë).



Është detyrë e juaja që të merrni mësimë prej mësimëve të saj rreth bujarisë dhe nderit dhe ta bëni veten tuaj femër shembëllyese në zbatim të Islamit dhe të ligjeve të Kur'anit.

### **Virtyti është bukuri për gruan**

Profeti Muhamedi (s.a.s), ka thënë: *Virtyti është bukuri e femrës».*

Bukuria është në dy lloje :

- *Bukuri sipërfaqësore.*

- *Bukuri e vërtetë.*

Bukuria sipërfaqësore, është ajo e dukshme, e cila qëndron për një periudhë të caktuar kohore dhe pastaj, zhduket pa i shtuar njeriut asgjë në personalitetin e tij.

Ndërsa, bukuri e vërtetë është ajo e cila qëndron dhe i jep njeriut personalitet dhe ky personalitet ngrihet në horizontet e plota njerëzore.

Është e qartë dhe nuk ka dyshim në të, se bukuri e vërtetë është më tepër e domosdoshme se të tjerat, ajo është qëllimi për të cilën njeriu është i detyruar të sakrifikojë për atë.

Nëse tek njeriu nuk ndodhen ngjyra prej kësaj bukurie, tek ai nuk ndodhen absolutisht vlera për bukurinë e jashtme.

Turpi është bukuri për gruan siç thotë Profeti (s.a.s) dhe ai i jep gruas personalitet, bujari, lartësi, ndershmëri në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

Ndërsa kremërat, bojrat, parfumet, etj,... të cilat janë prej bukurisë së jashtme sipërfaqësore dhe të pa vlera, këto janë dëmtuese për gruan, veçanërisht nëse gruaja është humbëse e turp-it- *mos e lejoftë Zoti.*

Hixhabi është argument, i pastërtisë së gruas, i origjinalitetit dhe i bujarisë së saj.

Ndërsa zbulimi njollos famën e gruas dhe vendos shenjat e pikpyetjes mbi pastërinë dhe nderin e saj, sepse, gruaja e bëri trupin e saj ekspozitë për shikimin e mijëra njerëzve, gjatë gjithë kohës dhe nuk dihet, se sa duar e kërcënojnë trupin saj për shkak të zbulimit jashtë ambiendit shtëpiak ? !

Gruaja e zbuluar në realitet nuk dëmton vetëm se veten e saj, sepse, ajo:

**Së pari:** Humbet pozitën e saj tek Allahu.

**Së dyti:** Humbet pozitën e saj në shoqëri.

Përsa i përket humbjes së pozitës së saj tek Allahu, kjo është për shkak se ajo nuk i`u përul urdhërave të Tij dhe i kundërshtoi ligjet e ardhura nga Ai (xh.sh).

Ndërsa, humbja e pozitës në shoqëri, ndodh për shkak të mosmbulimit dhe zbukurimit të saj, sepse ajo e drejtoi veten e saj kah të papëlqyeshmet dhe përbuzjet.

Gruaja e mbuluar fiton dy pozita:

1- **Pozitën tek Allahu.** Ajo është e pëlqyer tek Ai (xh.sh), tek Engjujt e Tij dhe tek të zgjedhurit e Tij, sepse, ajo i`u përul Allahut të saj, zbatoi urdhërat e Tij dhe u mbulua me mbulimin të cilin Allahu ia caktoi asaj. Ajo, kur hedh hapat, mëshira e Allahut e shoqëron, Engjujt e qiellit kërkojnë mëshirë për atë {**Ndërsa ajo që është tek Allahu, është shumë më e mirë dhe e përhershme**} *Sure Kasas, 60.*

2 - **Pozitën në shoqëri.** Ajo është e respektuar dhe e nderuar, sepse, është e zbukuruar me moralin dhe është mbrojtëse e nderit të saj si dhe mbuluese e bukurive të saj, të cilat ia dhuroi Allahu (xh.sh).

## Dialog me vajzën krishtere

Kohë më parë një dijetari të fesë islame i ndodhi një ndodhi e mrekullueshme. Tek ai shkoi një vajzë e krishterë dhe i tha: Unë njoha shumë gjëra prej Islamit dhe më pëlqeu kjo fe si dhe ligjet e saj por, një ligj i vetëm u bë shkak i mos pranimit tim të Islamit.

Unë bëra dialogje me shumë persona rreth këtij ligji dhe nuk arrita në përgjigje bindëse.

**Vajza**- O dijetar! Nëqoftëse ti arrin të më sqarosh filozofinë e këtij ligji, unë do ta pranoj fenë Islame.

**Dijetari** - Cili është ai ligj?

**Vajza** - Ligji i mbulimit. Përse Islami e ka bërë mbulimin obligim për femrën? Përse nuk e lejon atë të dalë e zbuluar njëlloj si mashkulli?

**Dijetari** - A ke shkuar ndonjëherë në tregun e argjendarisë, në të cilin shitet floriri dhe sendet e çmurara?

**Vajza** - Po.

**Dijetari** - A e shikove se si shitësi i kishte vendosur floririn dhe sendet e çmueshme në kutia xhami dhe i kishte kyçyr ato?

**Vajza** - Po.

**Dijetari** - Përse, ai nuk i vendosi floririn dhe sendet e çmueshme në mesin e duarve? Përse i vendosi në kutia xhami dhe i kyçi ato?

**Vajza** - Me qëllim që t'i ruajë ato pre hajdutëve dhe duarve të grabitësve.

**Dijetari** - Këtu qëndron edhe filozofia e mbulimit, sepse, gruaja është si bima aromatike, gruaja është si xhevahir i

çmuar, prandaj, është detyrë që ajo të mbrohet prej të ligëve dhe çrregulluesve. Po ashtu, është detyrë mbrojtja e saj prej syve të krimineleve, ashtu siç mbrohet diamanti i çmuar. Hixhabi (*mbulimi*), është i vetmi mbrojtës për atë. Femra e mbuluar është e siguruar prej të ligëve, sepse, trupi i saj është i mbuluar, bukuritë e saj janë të padukshme, njerëzit nuk shohin asgjë prej saj dhe nuk lakmojnë për atë. Por, përkundrazi ata e lartësojnë, e respektojnë dhe turpurohen prej saj.

Të gjitha këto ndodhin për shkak të Hixhabit (*mbulimit*). Pra, hixhabi është mbrojtës për ty, ruajtës i nderit dhe i virtytit tënd.

Kjo moj vajzë, është një prej anëve pozitive të filozofisë së hixhabit.

**Vajza e krishterë** buzëqeshi e gëzuar dhe tha:

Tani u binda për këtë ligj të islamit dhe e mësova urtësinë e tij. Zoti e bekoftë hyrjen time në Islam..

Pastaj dëshmoi dy dëshmitë (*Eshhedu en la i lahe il-lall-llah, ve eshhedu ene Muhammeden abduhu ve resuluhu*).

Ky dailog i shkëlqyer na sqaron më së miri, se Islami dëshiron mbrojtjen e nderit dhe begatinë e femrës. Ai kërkon mbrojtjen e shoqërisë dhe pastërtinë e saj. Për këtë, islami e bëri të detyrueshëm hixhabin.

## Dallimi në mes gruas së mbuluar dhe asaj të zbuluar

Një shoku im, më tregoi rreth një ndodhie të çuditshme e cila i kishte ndodhur një besimtari.

Ky besimtari, një ditë po shëtiste sëbashku me gruan e tij të mbuluar në një park argëtimi. Në atë kohë, atij i afrohet një qesharak sëbashku me gruan e tij të zbuluar dhe e pyet atë: Përse gruaja jote është e mbuluar? Përse nuk del e zbuluar sikurse edhe gruaja ime?

E përse mbulimi?

Përgjigja e **besimtarit** ishte e shkëlqyer dhe kurjoze kur i tha atij: A e din dallimin në mes gruas së mbuluar dhe asaj të pa mbuluar?

Ai **qesharaku** tha: Ku është dallimi?

**Besimtari** ia ktheu: Ku është dallimi në mes makinës «Taksi» dhe makinës private?

**Qesharaku** tha: Dallimi është se makina private është e veçantë vetëm për pronarin e saj dhe jo për të tjerët.

**Besimtari** tha: Po ashtu është gruaja e mbuluar me atë të pambuluar. Të pa mbuluarën e shikojnë të gjithë njerëzit, shikojnë bukuritë e saj, trupin e saj, etj... dhe ndoshta e përdhunojnë atë – siç ndodh shumë herë.

Ndërsa, gruaja e mbuluar është zonjë e ndershme dhe e posaçme vetëm për burrin e saj, atë nuk e shikojnë burrat e tjerë, nuk e lakmojnë të ligët dhe fesadçijtë, ajo nuk e shfaq fytyrën dhe bukuritë e saj para syve të imoralëve, ajo është e ruajtur me hixhabin, nderi i saj është i mbrojtur, trupi i saj

është i mbrojtur, etj... Në të njëjtën kohë, ajo është e dashur tek bashkëshorti i saj dhe e respektuar, sepse, ai e di se ajo nuk e tradhëton, e di se ajo është e posaçme për të (*në shikime*) dhe se ajo nuk kryen marrdhënie të pa pëlqyera me të tjerët.

**Qesharaku** u turpërua dhe i tha besimtarit:

Unë, të kërkoj ndjesë se të bezdisa. Këto fjalë janë mjaftë të rregullta dhe shembulli është i mrekullueshëm. Unë, të kërkoj ndiesë për ato fjalë që të thashë dhe pendohem tek Allahu për të kaluarën time.

Gruaja e tij ndërhyri në bisedë e tha:

Po, pasha Allahun... këto fjalë janë të sakta dhe shembulli është i bukur. Unë, më parë nuk kam dëgjuar të njëjtë me këtë shembull, i cili më pushtoi tërë zemrën time dhe unë gjithashtu pendohem tek Allahu (xh.sh).

Bashkëshorti i saj u rikthye në bisedë për të plotësuar thëniet e tij dhe tha: Tani, unë besoj në hixhab dhe që nga kjo ditë gruaja ime do të hyjë në lulishten e bujarisë dhe do të dalë prej shtëpisë e mbuluar me hixhabin e Islamit dhe me petkun e imanit, sepse, ndërgjegja ime e kundërshton që gruan time ta shikojnë të gjithë njerëzit.

## **Çfarë qëllimi kanë misionarët e zbulimit?**

Pas studimeve të shumta, kundërshtarët e Islamit, vendosën disa plane për të goditur në mënyrë të shkallëzuar Islamin dhe muslimanët.

Plani më parësor, prej planeve të tyre djallëzore, të cilët i përdorën për goditjen e Islamit dhe muslimanët ishte thirrja në mosmbulim dhe në shkatarrim.

Në emër të artit ata ftuan në fesad, në emër të përparimit ftuan në devijim, në emër të qytetërimit ftuan në të këqija, në emër të lirisë ftuan në zhveshje.

Vërtet, shumë musliman - gra dhe burra- u mashtruan prej këtyre thirrjeve, duke shkuar pas fjalëve të helmuara, të cilat i çuan ata në fatkeqësi dhe vuajtje.

Gratë dhe vajzat muslimane filluan t'a kundërshtojnë veshjen e ndershme të Islamit (*Hixhabin*). Ato filluan të dalin prej çerdhes së imanit e nderit dhe hynë në humnerat e skëterrës, duke përdorur veshjet e ardhura nga vendet përparuese!!!

Qëllimi i kundërshtarëve dhe i keqdashësve të Islamit u vërtetua, shoqëria Islame ra në strofkën e shkatarrimit dhe të të këqijave, ajo u kthye në një shoqëri të çrregullt e të përçarë, pasi ajo ishte shoqëri e rregullt dhe e pastër, në të u përhapën krimet, ngjarjet e përdhunimit, të rrëmbimit si dhe abortet.

Tani u bë e dukshme se misionarët të cilët ftojnë në mosmbulim, në realitet ata ftojnë në shkatarrim dhe e tërheqin gruan për në thertore. Ata kërkojnë të therin nderin

dhe pastërtinë e saj, të rrjepin bujarinë dhe begatinë e saj me emrin e parrullave të zbraza dhe të thënieve të pa vlera.

O lexues i dashur! Nëse dëshiron të njihesh më mirë me fjalët e mia, pyeti të thinjurit, baballarët tuaj, gjyshërit tuaj, të cilët akoma vazhdojnë ta kujtojnë të kaluarën. Pyeti ata: A ndodheshin këto krime, aksidente, përdhunime, në ato kohëra, pra, para 30 vjetësh apo 50 vjetësh?

Sigurisht, përgjigja e tyre do të jetë:

jo... jo... jo.

Nga kanë ardhur këto krime dhe aksidente?

Ata do të të thonë: Prej shumë gjërave, e më kryesorja është zbulimi dhe zbulurimi (*në rrugë*). Kjo është përgjigje e saktë.

Nëse kërkon të dish sa më shumë të vërteta, pyeti banorët e fshatrave të vogla të cilat zbatojnë Islamin, rregullat dhe ligjet e Tij të urta dhe udhëzuese.

Pyeti ata: A ndodhin në fshatrat tuaja krimet e përdhunimit dhe kërcënimet siç ndodhin në qytet?

Sigurisht, ata do të të thonë ty jo... jo..., sepse shoqëria e tyre është e mbojtur me Islamin dhe ligjet e tij të larta e udhëzuese.

Ndërsa, në qytete, të cilat ftojnë në përparim dhe qytetërim, krimet shtohen dita ditës me mënyra të çuditshme, edhe pse ka dënime të ashpra të caktuar nga ana e shtetit për kriminelët.

Kjo tregon se, ligji nuk është i mjaftueshën, por duhet që të shkulen rrënjët e fesadit në fillim, me qëllim që krimet të zhduken dhe të shfarosen, sepse, krimet e kanë prejardhjen nga qendrat e fesadit dhe të degjenerimit, siç janë kinematë e zhveshjes, filmat erotike, fotografitë e femrave nudo (të



zhveshura), të cilat botohen nëpër gazeta dhe revista, zbulimi dhe zbulurimi i tyre jashtë ambientit shtëpiak, etj...

Përderisa këto qendra akoma funksionojnë, do të shohim se krimet dhe ndodhitë e liga do të shtohen dita ditës dhe nuk mund të zhduken me ligjet e vendosura.



### **Cila është më e përsosura?**

Për ju, tani po japim dy shembuj prej shoqërisë, dy gra të cilat dallohen nga njëra-tjetra:

**E para:** Gruaja e mbuluar, e cila u mbulua me mbulesën e imanit, veshi rrobat e Islamit, fitoi begatinë e Mëshiruesit, u

ngrit në shkallët e parajsës dhe shtoi respektin, dashurinë, pastërtinë etj... për veten e saj.

Çdo person e shikon atë, por, nuk sheh gjë prej saj, dhe nuk e njih atë, a është vajzë e re apo grua e martuar, e bukur apo e shëmtuar?.

Ai e shikon atë me respekt e jo me përbuzje, sepse, ai e din se ajo është grua besimtare në fenë e saj, mbrojtëse dhe zbatuese e Islamit të saj. Ajo u largua prej të pa pëlqyerave, e kundërshtoi zbulimin dhe zbulimin dhe i'u shmang degjenerimit, devijimit, imoralitetit...

**E dyta:** Gruaja e pa mbuluar, e cila zhveshi petkun e turp dhe imanit (*ai njeri, i cili nuk ka turp nuk ka iman*) dhe kundërshtoi ligjet e Kur'anit.

Ajo u zhvesh dhe u zbulua njëllor si vepronin gratë e injorancës së hershme (*para Islamit*), duke u bërë e ngjashme me gratë jahudite dhe ato të krishtera dhe e la pas dore bujarinë dhe mbulimin e saj. Ajo shfaqti trupin e saj, fytyrën e saj, duart e saj, kraharorin e saj, për t'i shikuar të ligët dhe keqbërësit derisa të vënë dorë mbi to. Ajo e ekspozon trupin e saj njëllor siç ekspozohen mallërat nëpër tregje. Ndoshta, pas kësaj femrat do të poshtërohen, ndoshta, ato do të kërcënohen, ndoshta do të përdhunohen dhe të shkelet mbi pastërtinë e tyre, dhe, si pasojë, ato do të humbasin nderin dhe fisnikërinë e tyre.

Pas kësaj ato do t'i presin fatkeqësitë, vuajtjet, zemërimet etj... e të gjitha këto për shkak të zbulimit.

Pasi i njohët të dy grupet e lartpërmendura, ejani, që sëbashku të bëjmë krahasimin në mes tyre sipas gjykimit të llogjikës së shëndoshë dhe të shtrojmë këtë pyetje: «*Cila prej atyre dy grave është më e përsosur*»?

Cila prej atyre të dyjave është më fisnikja, më e respektueshëmja dhe ka pozitë më të lartë?

E mbuluar e mbrojtura?

Apo, e zbuluar e zbuluar?

Sigurisht, gruaja e mbuluar, ajo është më e përsosur, më e lartësuar, më e repektuar dhe më e ndershëmja, e cila i fiton të dy botët.



## Mosmbulimi, kolera e shoqërisë

Pikpamja e Islamit për shoqërinë është shumë e përsosur, sepse, ai urdhëron për një shoqëri të pastër, në të cilën mos të shihen ndikime të degjenerimit dhe të padrejtësisë.

Prej atyre çështjeve që i siguron shoqërisë paqë dhe pastërti është edhe ligji i hixhabit.

Ky ligj, e mbron gruan prej degjenerimit e imoralitetit, dhe, e ndalon atë prej devijimeve të shumëllojshme.

Me këtë ligj, Islami i siguron shoqërisë siguri dhe mbrojtje.

Prej elementeve kryesore të pastërtisë së shoqërisë është zbatimi i këtij ligji, pra i hixhabit (*mbulimi*).

Është e pa mundur të arrihet pastërtia e shoqërisë në kohën kur në atë shoqëri ndodhet zbulimi dhe zbulimi i grave jashtë ambientit shtëpiak, sepse, zbulimi është kolera e shoqërisë. Nëse, kjo kolere do të përhapet në shoqëri, banorët e saj shkojnë drejt shkatërrimit dhe asgjësimit.

Ne i shikojmë me sytë tanë ato shoqëri, në të cilat është përhapur «kolera» e zbulimit, se si ato janë të zhytura në shkatërrim e në devijim moral dhe tek ato ndodhen krime dhe tradhëti.

Islami kërkon shkullien e rrënjëve të fesadit e të krimeve, duke përdorur disa rrugë, ku më kryesorja e tyre është ajo e përhapjes dhe zbatimit të Hixhabit (*mbulimi*).

Islami e lufton fesadin dhe veglat e tij, dhe, një prej veglave më kryesore të fesadit, është zbulimi dhe zbulimi i femrave jashtë ambientit shtëpiak.

## Mosmbulimi është shkatarrim

Prej fatkeqësive dhe ndikimeve negative të mosmbulimit të femrave është shkatarrimi të rinjëve dhe të rejave.

Imam Ridhai ka thënë: «... *Shikimi i flokëve të femrave u bë haram, sepse, ai përmban ndikim negativ për meshkujt, si dhe shkaqe të cilat i ftojnë në fesade dhe në veprimin e veprave të palejuara dhe të papëlqyera*»<sup>(4)</sup>.

Çfarë do të ndodhë me atë femër, e cila ecën në rrugë e zbuluar dhe shkon në treg apo në vende të tjera, ku atë e shikojnë të rinjtë (*të cilët kanë arritur në shkallë të lartë përsa i përket epsheve seksuale*)?

Sigurisht, që epsheet e atyre djemve do të shtohen dhe mendojnë se si t'i shuajë ato.

Çfarë bëjnë?

Nëse këta të rinj nuk e besojnë Islamin e as rregullat e tij, ata do të strehohen, ose tek eksitimi (*Istimnau*) duke përdorur mënyra të ndryshme, deri në përdorimin e mardhënieve të rralla homoseksuale (*burrë me burrë*), ose do bëjnë zina, pasojë e së cilës është shkatarrimi i ndereve.

Të gjitha këto “*vepra kriminale*”, të cilat janë në kundërshtim me ligjet e Allahut dhe me fenë e Tij, sjellin sëmundje të rrezikshme dhe fatkeqësi të shumta.

Në një studim thuhet: *Numuri i spitaleve të posaçme për sëmundjet që lindin prej mardhënieve seksuale ilegale, në Amerikë ka arrit në 650 spitale!!*

---

(4) Biharul Envar V.6 F.103.

Ajo grua e cila del e zbuluar dhe bëhet shkaktare në rënien e të rinjve në haramë dhe në ndytësira, ajo konsiderohet partnere në krime dhe dënime, sepse, ajo nëpërmjet zbukurimit dhe veshjeve të modës (*siç shihet!!*), ndikoi në mënyrë negative në epshet seksuale tek të rinjtë.

Kjo është gjëndja kur djemtë nuk janë besimtarë.

Por, nëqoftëse këta të rinj dhe të reja e besojnë Islamin dhe rregullat e Tij, ata do t'i burgosin epshet seksuale në brendësi të tyre, i kundërshtojnë ato, mbështeten tek Zoti për t'i mbrojtur nga djalli dhe ushtarët e tij si dhe i durojnë këto fatkeqësi të ardhura prej atyre grave të pa mbuluara dhe të zbukuruara me veshjet apo zbukurimet e modës!



### **Mosmbulimi dhe krimet e përdhunimit**

Prej fatkeqësive dhe ndikimeve negative të mos mbulimit është, përdhunimi i femrave dhe mardhëniet seksuale me to në mënyrë të dhunëshme.

Është e natyrshme, se ajo femër e cila shfaq bukurinë e saj, ajo do të ndikojë në ndienjat e epsheve tek meshkujt. Për këtë, ajo do të paguajë vlerën e këtij veprimi, me trupin e saj dhe me nderin e saj. Shikimi i atij djali jo besimtar në drejtim të femrave të zbuluara dhe të zbukuruara, është i njëjtë me shikimin e ujkut për delet, dhe i njëjtë me shikimin e maces për miun.

Nuk është për tu çuditur, nëse femra bien në atë kurth të cilin e vendosi vetë për veten e saj dhe të ballafaqohet me kërcënimet e të ligëve.

Përdhunimet në vendet perëndimore janë të çuditshme në numër!!

Në një botim të gazetës Britanike Gardian është shkruar: *“Proçes verbalët e policisë amerikane tregojnë se krimet e përdhunimit rriten vit pas viti... Vetëm në Uashington për çdo 15 minuta ndodh një krim përdhunimi”!!!*

*«Në kryeqytetin e Britanisë në vitin 1970 ndodhën 2090 ngjarje kërcënimi të ndryshme mbi gratë dhe vajzat!!...»*

Unë dëgjova se një kryetar i Republikës së njërës prej shteteve arabe herë pas here bënte vizita në universitete dhe takohej me studentët.

Në një prej vizitave të tij, ai ia nguli sytë studentes më të bukur e pastaj del prej klasës... Mbas një kohe të shkurtër personat e rendit dhe të sigurimit shkojnë tek shtëpia e asaj vajzës që t'i thonë babait të saj se: Presidenti i republikës ka dëshirë që të kalojë një natë me vajzën tënde!!

Në familjen e asaj vajze bëhet kijameti kur dëgjojnë ato fjalë!

A munden ata që ta pengojnë kërkesën e presidentit?

A kanë mundësi të shpëtojnë prej kësaj fatkeqësie?

Cili do të jetë rezultati?

Asgjë..., veçse vajza do të shkojë me këmbët e saj tek skandali dhe do të kthehet mbartëse e humbjes së nderit të saj dhe kjo jetë do t'i bëhet skëterrë para syve të saj!!

O vëllezër: Ata të cilët lexojnë këtë fatkeqësi, apo dëgjojnë për atë, do të vëreni se ata do e mallkojnë këtë kryetar devijues imoral dhe do ta ofendojnë me fjalët më të fëlliqura.

Por, na lini të mendojmë pak rreth shkakut të kësaj fatkeqësie.

Hajdeni të shtrojmë këtë pyetje:

Kush është përgjegjësi i pare për këtë fatkeqësi?

A nuk është ai babai, i cili e lejoi vajzën e tij të dalë prej shtëpisë e pambuluar dhe e zbukuruar me makiazhe?!

Nëse, ajo do ishte e mbuluar... A do t'a lakmonte atë ai kryetar i poshtër? Babai është përgjegjës ditën kur bleu televizorin (*këtë armik të brendshëm mëktar*), me qëllim që të shohin programe qytetëruese, përparuese dhe bashkëkohore!?

Apo, kur ai vetë e dërgonte familjen e tij për të shikuar filma të cilat janë në kundërshtim me moralet fetare dhe ato shoqërore.

Po nëna, a nuk mban përgjegjësi për ato ditë kur ajo e zbukuronte vajzën (sikur të ishte dita e martesës së saj) pastaj e dërgonte në shkollë?! S`ka dyshim se edhe ajo është përgjegjëse edhe për ditën kur ajo zgjodhi për vajzën e saj të pafajshme, veshje të shkurta (*minifunda*), të ngushta dhe zhapone!.



Edhe vajza, po ashtu është përgjegjëse për këtë udhë të zezë në të cilën ajo ecën, sepse, ajo zgjodhi për veten e saj mosmbulimin, këtë rrugë të vështirë, të mbushur me gurë e gjemba.

Po... Këta janë përgjegjës të shkallës së parë, pastaj të mallkohet kryetari...



*Shoqata*

*filadi*

### **Mosmbulimi dhe krimet e abortit**

Prej shkatarrimeve të mosmbulimit dhe ndikimeve të tij negative është aborti i fëmijëve dhe coptimi i tyre me mjete të ndryshme prerëse, sepse, femra e pa mbuluar dhe e zbukuruar, siç thamë, ajo në shumë raste është ballafaqese e poshtërimeve të djemve qesharakë dhe të pa moralshëm, ku në shumë raste ajo bëhet gjah në duart e tyre, duke e përdhunuar atë dhe duke shkelur mbi nderin e saj. Rezultati përfundimtar do të jetë se ajo do të mbetet shtatzanë në mënyrë të parregullt dhe ndaluese (*haram*)... Për këtë, ajo nuk gjen rrugë tjetër për të shpëtuar prej këtij skandali, veçse të bëjë abort dhe të nxjerrë fëmijën prej barkut të saj.

Kjo, ka ndodhur dhe po ashtu ndodh në vendet e qytetëruara. Në një raport të veçantë thuhet se: «Në Londër, në vitin 1970 numuri i gjendjeve të abortit u rrit nga 50 mijë i cili ishte në vitin 1969 në 83 mijë dhe në vitin 1971 afërsisht në 200 mijë raste.

Në Francë në çdo 200 lindje, aborti arrin në 46-143 raste... në Bashkimin Sovjetik numuri i abortit (*dështimit*) arrin në 6 milion raste..<sup>(5)</sup>

Këto shifra numerike të tmerrëshme dhe frikësuese, nuk janë veçse rezultate të femrave, të cilat dalin të pambuluara dhe të zbukuruara jashtë ambjentit shtëpiak.

Nuk ka mbrojtje prej këtyre krimeve, veçse me zbatimin e ligjit të hixhabit (*mbulimit*).



---

(5) Botim i gazetës Libaneze «Dita» e datës 28/2/1972.

## Mosmbulimi dhe tradhëtia bashkëshortore

Që nga dita, kur mos mbulimi u përhap në mesin e femrave kanë ndodhur tradhëti bashkëshortore dhe numuri i tyre akoma është në rritje dita ditës.

Në të shumtën e rasteve, shkaktari i parë për tradhëtinë është bashkëshorti, sepse, ai e shoqëron bashkëshorten e tij në festa të devijuara, në kinema, në kënde argëtimesh etj... Ndoshta, në ato vende ajo njihet me persona të tjerë dhe ato njihen me të... e më vonë bashkëshorti i saj i fton ato në shtëpi si miq dhe njëkohësisht gruaja e tij i mirëpret ata persona me buzëqeshje, i takon ato me dorë, i qeras ato me fruta dhe ëmbëlsira njëlloj sikur ajo të ishte e afërmja e tyre.

Ditët kalojnë... dhe papritur bashkëshorti e kupton se bashkëshortja e tij ka marrëdhënie me iks (x) person apo shok, ose me atë burrë të huaj...etj.

Nga këtu, ai revoltohet dhe shpërthen si vullkan mbi bashkëshorten e tij, duke ditur se ai është shkaku i kësaj fatkeqësie, sepse, ai e çoi gruan e tij në këtë udhë të zezë dhe ai është parapërgatitës i këtij krimi!

Në këto momente, ky bashkëshort e sheh veten e tij para dy gjërave:

Të qëndrojë me këtë grua «*Tradhëtare*» dhe të jetojë i mbuluar me tortura dhe me dhimbje shpirtërore, në veten e tij, ose të shkojë në gjykatë për të firmosur çertifikatën e divorcit dhe të ngrejë aktpadi për bashkëshorten e tij!

Disa bashkëshortë, divorcin e konsiderojnë si mënyra më e mirë për zgjidhjen e problemeve në shumicën e rasteve, por

ama, kjo pas skandalizimit dhe turpërimit në shoqëri! Prej këtu, shkatërrohet, shtëpia familiare, jeta bashkëshortore shembet, dhe, fatkeqësitë bien mbi fëmijët, sepse, ata humbasin nënën e tyre së bashku me dashurinë dhe ngrohtësinë e saj në periudhën e tyre më delikate që është periudha fëminore. Ata, do të rriten larg dashurisë dhe dashamirësisë, nuk do të paisen me edukatën e kërkuar dhe në zemrat e tyre do të zënë vend urrejtja dhe ndjenjat për mangësi në shoqërinë ku ata jetojnë.

Pastaj ata do të shëndërrohen në grupe hadjutësh dhe kriminelësh.

Po! Kjo ndodh në vendet devijuese. Në një shkrim të cilin e botoi gazeta sovjetike «Pravda» thuhet se: *80% e të gjitha thyerjeve të ligjeve të cilat i kryejnë të rinjtë e kanë burimin tek shpërbërja e familjes dhe prej rasteve që përfundojnë me divorc.*

*Shkaku kryesor i kësaj dukje shoqërore është: shkatërrimi moral dhe përdorimi i pijeve alkolike<sup>(6)</sup>.*

Këto janë prej rezultateve të mosmbulimit. Islami e ka ndaluar (*haram*) zbulimin, sepse, ai është shkaku i të gjitha fatkeqësive. Ai e ka bërë atë (*zbulimin*) *haram* për të mbrojtur shoqërinë prej këtyre çrregullimeve.

Islami e ka bërë hixhabin detyrë për gratë me qëllim që ato të largohen dhe të mbrohen prej këtyre krimeve.

Çdo ditë gazetat na informojnë rreth tradhëtie bashkëshortore, të cilat ndodhin për shkak të mosmbulimit dhe zbulimit, e që arrijnë në divorc apo krim.

---

(6) Gazeta «**Ihram**» e Kairos e datës 24/4/1966, marrë nga gazeta Pravda.

Sa kemi lexuar apo edhe dëgjuar se një iks (x) person u divorcua me gruan e tij sëbashku me fëmijët, për shkak se ai u martua me një vajzë të cilën e njohu në qendër argëtimi apo në një vend zbavitës ose diku në vende të tjera.

Gjithashtu ne kemi dëgjuar apo kemi lexuar se një grua u largua prej burrit të saj për shkak se ajo u martua me një djalë të cilin e njohu në kinema apo në bregdet, apo...

Në sa gazeta apo revista lexojmë se: Një burrë vrau shokun e tij me qëllim që të martohej me gruan e tij, e cila dilte para tij e zbuluar dhe në mënyrë mohuese të turpfit dhe hixhabit...

Po ashtu përmendin se: Një grua vrau burrin e saj në bashkëpunim me të dashurin “*ashikun*” e saj, të cilët e coptuan trupin e tij dhe e hodhën në kazanin e plehrave. Këtë ajo e bëri me qëllim që pas atij krimi të fëlliqur të martohet me atë “*ashikun e saj*”!!

Një gazetë arabe ka përmendur një rast prej rasteve të tradhëtisë (*dhe sa shumë kanë filluar të përhapen këto llojë rastesh në ato vende*), i cili vërtet është një rast i dhimbshëm. Ajo, që është për të të ardhur keq më shumë, është se kjo ngjarje ndodhi në një prej vendeve Islame. Nëse do të ndodhte në vendet perendimore, ndoshta do të ishte më e lehtë, sepse, dihet që në ato vende janë të përhapura qendra të prostitucionit, e të tjera si këtos.

Por, përse të ndodhë në vendet Islame që janë të pastra prej këtyre ndytësirave dhe të pastra prej shkatarrimeve e çrregullimeve??

S`ka dyshim, se këto tradhëti dhe krime lindin prej mosmbulimit. Ato, janë rezultat i zhveshjes së femrës dhe i kundërshtimit të saj për mbulim, e atëherë kuptohet se nuk ka shpëtim prej këtyre tradhtive dhe krimeve, vetëm e vetëm me

zbatimin e ligjit të hixhabit siç urdhëron Zoti dhe i Dërguari i Tij.

Unë po ju kujtoj juve një ngjarje, me qëllim që të mësoni se sa i domosdoshëm është hixhabi dhe se çfarë shkatarrimesh sjell mosmbulimi :

Lojtarët e mundjes së një qyteti i dërguan ftesë një prej kampionëve të mundjes së një qytetit tjetër.

Ky i fundit e pranoi ftesën dhe shkoi në atë qytet sëbashku me gruan e tij të bukur, por e pa mbuluar.

Në aeroportin e atij qyteti, lojtarët dhe mundësat ishin në pritje të këtij mundësi, sigurisht ky mundësi i takoi ata me mallëngjim. Pastaj, filloi gruaja e tij t'i takojë me dorë, të cilën Islami e ka ndaluar këtë lloj takimi.

Lojtarët e takuan gruan e tij me ngrohtësi dhe buzëqeshje. Njërit prej atyre ajo i hyri në zemër dhe mendoi të martohet me të. Ai u largua dhe filloi të planifikojë për këtë gjë... dhe së fundi e realizoi planifikimin e tij kur u takua fshehtazi me gruan e atij mundësit, të cilën e mashtroi atë me mënyrë djallëzore.

Ai i tha asaj: Me gjithë këtë bukuri që ke, ti je gruaja e këtij burri?!!

Kjo është padrejtësi për të drejtën tënde, sepse, ti je më e lartë se ai dhe unë jam i gatshëm që të martohem me ty me kusht që burri yt të të lëshojë (*divorcojë*) ty.

Me këto fjalë helmuese, ai, arriti ta mashtrojë atë të gjorën por që ishte mjaft tërheqëse. Ata ranë në dakort që ajo t'i kërkojë burrit të saj divorcin, e pastaj ai të martohet me të pas divorcit.

E gjitha kjo... dhe burri i saj nuk mori vesh asgjë se çfarë ndodhi...

Ditët e vizitës mbaruan. Mundësi, sëbashku me gruan e tij u kthyen në vendin e tyre.

Kur u kthyen, ai sheh një shëndërrim të keq në moralin e gruas së tij dhe në veprimet e saj, sepse, ajo para se të shkonte në atë vendin tjetër, i buzëqeshte atij, bënte shaka me të, i harronte atij dhimbjet ndërsa sot u ndodhi e kundërta e së kaluarës... Ai e pyeti rreth shkakut të këtij shëndërrimi të keq të saj moral?

Ajo i tha: Ti më ke mashtruar!

Ai i tha i çuditur: Unë! Si të kam mashtruar?!

Ajo i tha: Ti nuk je i përshtatshëm për mua, unë jam më e mirë se ti dhe se ndodhet një person i cili është më i përshtatshëm për mua.

Unë të kërkoj divorcim (*ndarje*)!!

Kur burri dëgjoji këto fjalë të saj, atij i fluturoi mendja dhe u befasua me një befasim të habitshëm e të papritur, shkakun e të cilit ia ktheu vetes së tij në ditën kur shkoi me gruan e tij të «pa mbuluar» në atë vend.

Ai u përpoq t'ia kthente asaj mendjen, por, përpjekjet e tij ishin të pa vlera... dhe së fundi, ai e divorcoi atë.

Ajo, shkoi tek ai qyteti tjetër dhe me vete mbante certifikatën e lëshimit për tu martuar me atë që ra dakort... !

Si thoni: A u martua me burrin e dytë?! A jetoi me atë?

Është e qartë se kjo llojë martese nuk zgjat shumë, sepse, ai nuk u martua me të për të ndërtuar jetë bashkëshortore, por, ai u martua me të me nxitje për dëshirë qejfi!. Kur ai

mbaroi punë me atë dhe i ngopi dëshirat e tij kafshore, e ndau atë që të kthehet në vendin e saj e dëshpëruar, e mërzitur,...

Me këtë veprim, ajo humbi burrin e parë me të cilin jetonte me dashuri, dashamirësi dhe mirëkuptim.

Mendohu thellë i dashur lexues në këtë ndodhi, e cila është një prej mijëra ndodhive tradhëtare bashkëshortore që të arrish në përfundimin se shkaqet e këtyre tradhëtive janë mosmbulimi dhe zbukurimi.

Nëse ajo gruaja do të ishte e mbuluar a do të biente në këtë kurth gjuetie?! A do ndodhej bashkëshorti në atë fatkeqësi të cilën ia ktheu vetes së tij?!

Ky është shpërblimi i atij që kundërshton ligjin Islam dhe rregullin e Kur'anit.





## **Rroli i kinemave në drejtim të mosmbulimit dhe shkatarrimit**

Kinematë luajnë një rrol të madh dhe ndikojnë së tepërmi në shkatarrimin e shoqërisë dhe në devijimin e rinisë prej rrugës së vërtetës dhe fisnikërisë.

Rroli i tyre duket në mënyrat e shfaqjes së filmave erotik, të cilët ndikojnë në shtimin e lakmive të djemëve dhe vajzave. Kinematë e zhveshin rininë prej turpfit dhe besimit duke i drejtuar këto djem dhe vajza kah devijimi dhe imoraliteti, dhe kah zbulimi e zbulurimi.

Këto kinema në shumicën e rasteve bazohen tek femrat aktore të zbuluara, të cilat luajnë rolin e zhveshjes nëpër filma. Në disa raste shkalla e zhveshjes arrin deri në atë pikë sa që këto autore zhvishen nudo (lakuriq) para shikuesve, për të shtuar sa më shumë lakmitë dhe shkatarrimet.

*Gazeta Libaneze «En – Nehar», numuri 1311, botoi një ndodhi, se një djalë shikoi një film erotik. Pasi përfundoi shfaqja e filmit, ai shkoi në shtëpi dhe përdhunoi motrën e tij të vogël, e cila po flinte, me të njëjtën mënyrë skandali të ndytë siç e kishte parë në kinema. Ky përdhunim i shkaktoi vajzës hemoragji derisa vdiq.*

Po! S`ka dyshim, që këto kinema janë qendra të kolonizuesve, të ngritura me qëllim që të luftojnë hixhabin të zbulojnë femrat dhe t`i vendosin ato në prehërat e të këqijave e të imoralitetit.

Po ashtu, ato janë qendra të shkatarrimit të djemve tanë që t`i shndërrojnë ata në hyzmeqarë të seksit dhe kërkues të

qejeve, derisa të mos mendojnë për përparimin shoqëror, industrial dhe kulturor, por, këto përparpime të jenë vetëm për kolonizatorët, ndërsa, ne muslimanët të qëndrojmë të nënvleftësuar, të prapambetur, të nevojshëm për ata për çdo gjë, qofshin të mëdhaja apo të vogla ku ata të bëhen pronarët tanë dhe të veprojnë si të duan.

Këtu e shikoj të domosdoshme t'u bëj thirrje të gjithë muslimanëve të cilët mbartin ndjenjën për përgjegjësinë fetare, t'i luftojnë ato kinema dhe të ngjashme me ato, t'i ndalojnë njerëzit në vajtjen e tyre tek këto qendra të zhevshjes, t'i paralajmërojnë ata se këto qendra nuk i shërbejnë veçse interesave e armiqëve dhe, se këto qendra janë shkatarruese për shoqërinë njerëzore.

Të gjitha këto, kolonizatorët i kryejnë me emrin e artit, kulturës dhe të kinematografisë!!!



### **Mikrobi i përzierjes**

Fjala përzierje ka kuptimin që, gratë dhe burrat të ulen pranë njëri-tjetrit pa patur pengesë në mes tyre. Kjo, në

Sheriatin Islam nuk është e lejshme dhe është e urryer tek Allahu (xh.sh).

E Përse?

**Së pari:** Ky veprim është në kundërshtim me ligjin Islam të hixhabit dhe sjell shkatarrime e fatkeqësi.

**Së dyti:** Ajo është shtrues i rrugës së mardhënieve seksuale në mënyrë ilegale.

**Së treti:** Ajo është shkaktare e shkatarrimit të familjeve dhe i përçarjes së tyre.

**Së katërti:** Ajo sjellë vuajtje dhe çrregullimeve për të dy palët.

Pra, përzierja është mikrob përçarës, i cili përhapet në bazat e shoqërisë dhe fillon ta thërmojë pak e nga pak derisa t'i rrëzojë bazat e saj.

Përzierja është sëmundje e rrezikshme, e cila është shkatarruese për familjet dhe për sistemin familjar. Ajo është sikurse kanceri, prej të cilit nuk ka siguri prej tij por vetëm me zhdukjen e tij të plotë rrënjësor arrihet të fitohet siguria.

Për këtë shohim se në ato vende ku është e përhapur përzierja (*burrat dhe gratë qëndrojnë në një vend*), në këto vende hasim me krime të shumta dhe imoralitete të pa kufijshme. Numuri i krimeve është në rritje dita ditës, veçanërisht në universitet e përzierra, derisa këto universitete e kanë humbur origjinalitetin e tyre, pasi këto ishin universitete të kulturës dhe të diturisë, sot janë bërë qendra të shkatarrimit dhe fesadit për shkak të kësaj përzierje në këto universitete.


Gjykatësi Amerikan Lendesi thotë: «45% e vajzave të shkollave të përbashkëta, e humbasin virgjininë e tyre para

*se ta përfundojnë këtë shkollë dhe ky veprim është më i madh në shkallët e larta të studimit...»*

*«Statistikat të cilat u zhvilluan në Britani arriten në konkluzionin se 70% e studenteve mbani në çantat e tyre me vete ilaçe penguese të shtatzanisë. Kjo tregon se këto vajza janë të gatshme të kryejnë mardhënie seksuale në çdo kohë».*

Pas leximit të kësaj statistike, e cila është e pakëta e të shumtave, kuptohet urtësia e lartë e ndalimit të uljes së përbashkët dhe se Islami kërkon që ta largojë shoqërinë prej këtyre imoraliteteve, shkatarrimeve dhe fatkeqësive, të cilat janë rezultat i mosmbulimit dhe i përzierjes.

Nga këtu themi se, Islami e ndalon përzierjen në të gjitha vendet, në shkolla, në universitete, në festa, në grumbullimet e përgjithshme, etj... për të mbrojtur familjen dhe shoqërinë prej krimeve të shumëllojshme.



### **Islami nuk është fe e mendimeve**

Në disa mjete të informacionit dhe të shtypit hera herës lexojmë ose dëgjojmë se disa persona “mendjemëdhenj”, japin mendimin e tyre personale për disa ligje të Islamit, për çështjet e sheriatit dhe i kritikojnë ato sipas mendimit të tyre personal e të kufizuar.

Prej atyre ligjeve të Islamit, i cili është bërë qëllim i lapsave të tyre, është ligji i hixhabit. Në gazeta lexon se në një konferencë shtypi, iks (x) person thotë: Unë nuk jam i një mendimi me hixhabin! Nuk shoh pengesë në përzierjen e burrave dhe grave!! E fjalë të tjera pa përgjegjësi.

Është detyrë që t'i themi këtij dhe atyre të ngjashëm me të:

Cili je ti?! Cilët jeni ju ?!

Kush je ti që jep mendimin tënd rreth statutit qiellor?! Cila është vlera jote para ligjeve të Allahut dhe rregullave të Islamit?!

A është Islami fe e mendimeve dhe e pikpamjeve përderisa ti thua: për mendimin tim është kështu dhe në pikpamjen time kështu...?!

Pastaj ne i drejtohem këtij: Ti, a je musliman? Nëse je musliman në realitet, është obligim për ty që t'u përulesh urdhërave të Allahut dhe ndalimeve të Tij, të zbatosh rregullat e Islamit dhe ligjet e tij, ku prej këtyre është edhe ligji i hixhabit.

E nëse nuk je musliman, atëherë, ti nuk ke të drejtë të ndërhysh në ligjet e Islamit dhe t'i kritikosh ato duke dhënë mendimin tënd të «rrallë» për muslimanët.

Këtu, ne çuditemi prej këtij guximi mbi Zotin dhe të Dërguarin e Tij dhe se si mendjemadhësia dhe vetëpëlqimi i këtij personi të krijuar e të dobët, arrin të kritikojë ligjet dhe rregullat e Allahut. Më duket se ai nuk e ka dëgjuar thënien e Allahut i cili thotë: **{Dhe kush nuk gjykon me atë që e ka**

**zbritur Allahu ata janë mohues} {... Mizorë...}  
{Mëkatarë të dalë nga rruga e Allahut} <sup>(7)</sup>.**

Përgjegjësia e tyre është e madhe para Allahut (xh.sh), dhe ata do të japin llogari për këto fjalë (në shtesë të dënimt të rëndë), sepse ato shtyjnë dhe nxisin për mosmbulim, imoralitet dhe krim.

Ne besojmë se ata nuk shprehin ato që ndodhet në zemrat e tyre, por ata janë mjete në dorë të kolonizuesve që fshihen pas perdes, me qëllim që të thyejnë shpirtërat e muslimanëve dhe të shkatarrojnë djemtë dhe vajzat e tyre!

Ajo që të të tërheq vëmendjen është se këto mendime dhe konferenca shtypi përsëriten herë pas here nëpër revistat si dhe në gazetatat që botohen në vendet arabe!

Këto, nuk janë veçse kurthe dhe përpjekje të qëllimshme për shkatarrimin e shoqërisë së pastër Islame.

Është detyrë e muslimanëve që t'i kundërshtojnë këto gazeta të cilat u bënë trumbeta të kolonizuesve për të goditur Islamin dhe muslimanët.

Ky është obligim hyjnor dhe duhet që muslimanët të përpiqen me të gjitha mundësitë që zotërojnë, qofshin, materiale dhe shpirtërore, derisa kolonizuesit mos t'ia arrijnë qëllimit të tyre në drejtim të shoqërisë tonë Islame dhe në të njëjtën kohë kjo shoqëri të mos bëhet si «kopshtet zoologjike!» siç u bënë vendet perendimore, në të cilat kryhen mardhënie seksuale në rrugën e përgjithshme siç veprojnë kafshët, pa menduar se tek njeriu ndodhet turpi, nderi, fisnikëria, etj...

---

(7) Suretu Maide në tre ajetet: 44 – 45 – 46.



### **Çfarë vërtetuan thirrësit për mosmbulim?**

Tani le të shohim se çfarë vërtetuan thirrësit e mosmbulimit?

Çfarë vërtetuan ftuesit në «*lirinë e gruas*»?

Për t`u njohur me përgjigjen e kësaj pyetje, duhet patjetër të bëjmë një shëtitjetje njohëse në vendet e perëndimit dhe në shoqëritë e tyre, ose të hapim faqet e gazetave dhe të

revistave të cilat botohen në ato vende, me qëllim që të njohim gjëndjen e ulët në të cilën jeton femra e pambuluar në ato vende, sepse, çështja nuk mbaron me zbulimin e fytyrës dhe të këmbëve... por ajo e gjoksit... në veshjet e ngushta dhe ndikuese për epshet..., pastaj në të ngjashmen me zhveshjen... dhe.. në përdhunim, në abortim... e në fund vetëvrasje!

Kjo është ajo që ndodh në vendet «përparuese», të cilat i bëjnë thirrje gruas të zbulohet dhe të zbukurohet.

Përsa i përket shoqërisë tonë Islame ajo është e paralajmëruar për këto rreziqe të ardhura prej vendeve perendimore dhe lindore, të cilët sollën fesadin e tyre tek ne, në emër të «artit» dhe «shkencës».

Dihet, se sot numuri i krimeve në vendet tona Islame janë shumë të pakta në krahasim me ato krime që ndodhin në vendet e përparuara!

Shkaku i kësaj pakice krimesh është Islami i lartësuar, i cili fton në zbulimet me morale dhe virtyte, e që ndalon fesadin dhe të papëlqyeshmet.

Por rreziku është në ardhje dhe shkatarrimi po ashtu...

Pa japim për ju disa ngjarje të cilat ndodhin në ato vende që ftojnë në mosmbulim:

1 - «Afërsisht 10 filma të shkurtër rreth zhveshjes fotografohen për çdo javë në Britani dhe shumica e tyre shiten dhe po ashtu trasmetohen jashtë Birtanisë... pra afërsisht 500 filma në vit<sup>(8)</sup>».

---

(8 ) Gazeta kuvajtijane kabës numuri 18 datës 13/3/1972.



2 - Në Njujork ka kompani në të cilën bëjnë pjesë persona prej të gjitha krahinave të Amerikë dhe, numuri i tyre është 15 milion persona të cilët janë devijues kah seksi»<sup>(9)</sup>.

3 - Në vitin 1961 policia e Anglisë dërgoi për gjykim 100,000, femra të cilat merreshin me prostitucion dhe imoralitet. Dhe , se fundi policia informon për pamundësinë e saj për të kryer këtë mision...»<sup>(10)</sup>.

4 - Në Romë ndodhen 500 shtëpi publike ku në to ka me mijëra gra të cilat i shfaqin ose më mirë i shesin vetat e tyre tek burrat...»<sup>(11)</sup>.

Kjo është e pakta prej të shumtave...



### **O Motër muslimane**

Për ty po japim disa mësimë Islame të cilat Allahu (xh.sh) i ka caktuar për ty, me qëllim që të jetosh në lumturi dhe harmoni në këtë jetë dhe të fitosh begatitë e jetës tjetër.

Këto mësimë të ngrej në shkallët më të larta të virtytit, bujarisë, respektit dhe nderimit. Këto ligje janë sipërmarrëse

---

(9 ) Revizta kuvajtije Nehdhatu numuri 232.

(10 ) Libri! Çështja e martesë dhe e familjes F.130.

(11 ) Libri: Çështja e martesës dhe e familjes : F.145.

të mirësisë dhe shpëtimit tënd, me kusht që ti t'i praktikosh këto mësimë në jetën tënde.

1- **Hixhabi** (*mbulimi*) **para çdo gjëje**. Ai është fortifikatë sigurimi i cili të mbron ty prej degjenerimit dhe vepruesve të tij, të ruan prej fatkeqësive dhe prej keqbërësve.

Hixhabi është mesazhi i Allahut për ty, prandaj nënshtroju Allahut tënd, zbatoi urdhërat e Tij, sepse, këto urdhëra janë për interesin tënd dhe për mbrojtjen tënde, sepse, Krijuesi yt është Dashmirës për ty dhe nuk dëshiron veçse lumturinë tëndë.

Allahu (xh.sh) në Kur'an thotë: {... **Dhe mos e shfaqni bukurinë tuaj siç shfaqej në injorancën e hershme**}<sup>(12)</sup>.

{... **Të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre. Të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme, le ti vejnë shamiat mbi kraharorin e tyre dhe të mos u tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet...**}<sup>(13)</sup>

E mjera ti, nëse i kundërshton urdhërat e Tij, sepse, do të humbasësh të dyja botët.

Vlera e gruas qëndron në fenë e saj, në turpin e saj dhe në nderin e saj dhe hixhabi (*mbulimi*) që është çelësi i këtyre. Ai është lartësim, bukuri, respekt, etj...

Ndërsa, zbulimi është nënvleftësim dhe rrënim, prandaj largohu prej tij.

Rruga për në begatitë e Allahut dhe për në xhennet (*parajsë*) është zbatimi i hixhabit, e mjera ti, nëse devijon nga kjo

---

(12) Sure Ahzab ajeti 33.

(13) Sure Nur ajeti 31.

rrugë, sepse, do të humbasësh begatitë e Allahut dhe xhennetin e Tij.

Ndërsa, rruga e cila të çon tek dënimi dhe zjarri është mosmbulimi, e mjera ti, nëse e ndjek këtë rrugë, sepse, do të biesh në thellësi të zjarrit përvëlues.

Është detyrë e jotja që të njohësh vlerën tënde dhe mos ia shfaq trupin tënd dhe bukuritë e tua askërkujt, përveçse bashkëshortit tënd.

Profeti Muhamed (s.a.s) në një hadith me anë të cilit cilëson gruan e ndershme thotë: «Ajo i zbukurohet burrit të saj dhe u ruhet të tjerëve. Ajo e cila i dëgjon fjalët e tij dhe i zbaton urdhërat e tij.<sup>(14)</sup>

Pra, është obligim (*vaxhib*) për ty që të mbulolesh prej burrave të tjerë me mbulimin Islam, të cilin Allahu e ka bërë obligim për ty, në përshtatje me natyrën tënde dhe personalitetin tënd. Mos i shfaq bukuritë e tua para burrave të pa njohur dhe mos u bëj e njejtë si mallrat të cilat shfaqen nëpër tregje dhe në dyqane.

**2- Mos përdor makiazhe, bizhuteri dhe parfumëra.** Këto përdori vetëm në shtëpinë tënde dhe për bashkshortin tënd. E mjera ti, nëse i përdor këto mjete zbukurimi kur del prej shtëpisë tënde, sepse, ato të shfaqin ty para rreziqeve dhe kërcënimeve. Përdorimi i tyre të sjellin ty, urrejtjen e Allahut dhe mallkimin e Tij.

Profeti Muhamed (s.a.s) ka thënë: «Ajo grua që përdor erëra aromatike (*parfum*), pastaj del nga shtëpia e saj, ajo

---

(14) El Kafi: V.5. F.324.

*mallkohet derisa të kthehet në shtëpinë e saj, në çfarëdo kohe që të kthehet»<sup>(15)</sup>.*

Gruaja e mbuluar u largohet të gjitha atyre mjeteve, të cilat janë tërheqëse për burrat në drejtim të saj.

E kundërta ndodh me atë grua të zbukuruar. Ajo, me këtë veprim kërkon t'u tërheqë vëmendjen burrave, që ata ta shikojnë atë.

Prej atyre veprimeve “tërheqëse” është veshja e këpucëve me taka të larta të cilat japin tingëllime në rrugë njëlloj si patkonjt e kuajve!

Këto llojë këpucësh nuk janë në përputhje me mbulimin, ato janë të njëjta me «fërshëllimat» për t'i infomuar meshkujt, sepse, një grua po vjen.

Për këtë, shumica e njerëzve kur dëgjojnë trokitjet e këpucëve të grave ata i rikthejnë shikimet e tyre dhe shikojnë me hollësi të gjithë trupin e saj. A është i përshtatshëm ky veprim me mbulimin dhe respektin?

Po ashtu shtojmë se këto këpucë janë prodhime të shteteve kolonizuese dhe i sollën tek vendet e pastra Islame. Prandaj kujdes se mos bëhesh prej mjeteve të kolonizuesve, me dashje apo padashje!

**3- Mos u bëj e ngjashme me burrat**, në veshje, në pamje të jashtme, etj... por, bëhu e pamvarur në jetën tënde femërore.

Profeti Muhamed (s.a.s) ka thënë: «Zoti i mallkoftë ato gra të cilat bëhen të ngjashme me burrat dhe Zoti i mallkoftë ata burra që bëhen të ngjashëm me gratë»<sup>(16)</sup>.

---

(15) Biharul Envar: V.103 F.247.

4- **Mos i tako burrat e panjohur me dorë**, edhe nëse është prej të afërmëve tuaj siç është djali i xhaxhait, djali i tezes, etj... Kur një burrë i panjohur zgjat dorën e tij për t'`u takuar me ty, ti kërkoi ndiesë dhe thuaji atij se: *Feja ime dhe Zoti im, më ndalojnë në kryerjen e këtij veprimi.*

Nëse dikush zemërohet prej teje, mos i kushto atij kujdes, sepse dashuria e Zotit është më e domosdoshme se dashuria e njerëzve, por shtoji kujdes zemërimit të Allahut më tepër se zemërimit të njerëzve.

Në një hadith thuhet se Allahu (xh.sh) i tha Profetit Isa (Krishtit) (a.s): «*O Isa, nëse Unë jam i zemëruar ndaj teje nuk të bën dobi dashuria e njerëzve dhe nëse Unë jam i kënaqur me ty, nuk të dëmton zemërimi i njerëzve*»<sup>(17)</sup>

#### 5- **Mos u bëjë e turpshme kundrejt mbulimit**

Por, zbatoje atë me guxim dhe drejtësi edhe nëse ti banon në një familje jobesimtare, apo je në shkollë, ose ndodhesh në atë shoqërinë ku dominon mosmbulimi. Bëhu e drejtë dhe e vendosur në fenë tënde, e patundshme në qëndrimet e tua, ashtu siç thotë Allahu (xh.sh) në Kur'an: {**Ti o Muhamed, përqëndrohu vendosmërisht ashtu siç je urdhëruar...**}<sup>(18)</sup>

Allahu (xh.sh) thotë: {**s'ka dyshim se ata që thanë «Zoti ynë është Allahu», pastaj nuk u luhatën, atyre u zbresin engjujt (në prag të vdekjes) dhe u thonë:**

---

(16) El-Kafi: V.5. F.552.

(17) El-Kafi: V.8. F.138.

(18) Sure Hud ajeti 112.

**Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni, keni myzhde xhennetin që ju premtohet}**<sup>(19)</sup>.

Mos u zemëro prej fjalëve fyese të kundështarëve qofshin burra apo gra, por, përgjigju atyre me thënien e Allahut i cili thotë:

**{Nëse talleni me ne, edhe ne do të tallemi me ju ashtu siç po talleni ju}**<sup>(20)</sup>.

Natyra e devijuesve dhe të pamoralëshve ka qenë dhe është përbuzëse për besimtarët mbartësit e moraleve të pëlqyeshme. Kjo përshkak se ata e kanë humbur personalitetin dhe nuk kanë as argumenta e as llogjikë rreth devijimit dhe humbjes së tyre. Për këtë, ata strehohen në këtë mënyrë të pa vlerë për të shfajtuar vetat e tyre prej mëkateve dhe devijimit.

Të njëjtën mënyrë, të paaftë, ata e praktikonin dhe me të dërguarit, evlijatë dhe besimtarët gjatë gjithë historisë.

Allahu (xh.sh) thotë: **{E atyre kur u vinin të dërguarit ato vetëm e vetëm talleshin me to}**<sup>(21)</sup>.

Allahu (xh.sh) thotë: **{Mëkatarët ishin ata të cilët i përqeshnin ata që besuan. Dhe kur kalonin (besimtarët) pranë idhujtarëve ata i a bënë me sy njëri-tjetrit. Dhe kur i shihnin ata (besimtarët) thonin se ata janë të humbur}**.

I çmenduri e sheh veten e tij mendimtar dhe të tjerët i sheh si të çmendur, i pa moralshmi e sheh veten e tij të qytetëruar dhe të tjerët të prapambetur.

---

(19) Sure Fusilet: ajeti 30.

(20) Sure Hud ajeti 38.

(21) Sure Hixhër ajeti 11.

I padrejti e sheh drejtësinë të shtrembëruar...

Por, realiteti është në kundërshtim 100% me to.

Allahu (xh.sh) thotë: **{E sot në (ditën gjykimit) ata që besuan do të tallen me jo besimtarët}**<sup>(22)</sup>.

Ekziston ajo ditë ku Allahu dhe besimtarët do të përqeshin me jobesimtarët të devijuar dhe përqeshës.

Allahu (xh.sh) thotë: **{Allahu do të tallet me ta dhe Ai ua dha shpërplimin e talljeve të tyre, dënimin më të rëndë}**<sup>(23)</sup>.

**{... e ata që u tallën pësuan dënim përshkak se ata talleshin}**<sup>(24)</sup>.

Vërtet, atë ditë, qesharakët do pohojnë se, ata në këtë botë ishin të ligë, të humbur, të devijuar dhe përbuzës...

Pastaj, si rrufeja vjen përgjigjësja nga Allahu:

**{Ai thotë: Heshtni aty e mos flitni!}**

**{Pse një grup prej robëve të Mi thanë: Zoti ynë ne besuam, prandaj na fal dhe na mëshiro, se Ti je më i miri i mëshiruesve}.**

**E ju i patët tallur ata, sa që ajo tallje bëri që të harronin përkujtimin ndaj Meje, madje edhe qeshnit me to}. {E Unë sot i shpërbleva ata për atë që të durueshmit, ata janë fitimtarët}**<sup>(25)</sup>.

Pra, ti duhet të jesh krenare me hixhabin, sepse, me zbatimin e tij, i përulesh Allahut (xh.sh) dhe fiton shpërblim të

---

(22) Sure Mutafifinë ajetet 29, 30, 32, 34.

(23) Sure Tevbe ajeti 79.

(24) Sure En'am ajeti 10

(25) Sure Mu'minun ajetet: 108 – 111.

pa llogaritur kur je e mbuluar, për çdo hap që hedh. {**Ndërsa ajo që është tek Allahu (thevabi) është shumë më e mirë dhe e përhershme**}. Sure Kasas ajeti 60. {**Edhe një disponim nga Allahu që është më i madh**}. Sure Tevbe ajeti 72.

Ndërsa gruaja e pa mbuluar, ajo për çdo hap që hedh mbart mëkate.

## **6 - Besimi në vetvete nuk është i mjaftueshëm**

Në këto kohë shohim apo dëgjojmë femra të cilat thonë se, përderisa unë kam besim në veten time dhe jam e sigurtë se nuk do devijoj kah degjenerimi, atëherë a është detyrë që të zbatoj hixhabin?

Pëgjigje: Po.

**Së pari**, sepse hixhabi është obligim ligjor (në Sheriat) për ty, ke apo nuk ke besim në veten tënde.

**Së dyti**, besimi në vetvete nuk është i mjaftueshëm, sepse, {**...epshi është shumë nxitës për të keqen, përveç atë që e ka mëshiruar Zoti im...**}<sup>(26)</sup>

Sa të shumta janë ato vajza të cilat kishin besim dhe siguri në vetvete e pastaj rrëshqitën në humnerën e devijimit për shkak të mos mbulimit.

**Së treti**, mosmbulimi është faktori ndikues i epsheve seksuale për cilindo që të shikon ty. Ai është shtytës për në devijim dhe në veprimin e veprave të pa pëlqyera që janë në kundërshtim me moralin. A është e lejueshme kjo?

**Së katërti** Mosmbulimi ndoshta bëhet shkaktar për përdhunimit tënd, (Zoti mos e lejoftë). A është besimi dhe siguria në vetevete ndaluesi i kësaj gjëje (përdhunimit)?

---

(26 ) Sure Jusuf ajeti 53.



**7- Mos u mashtro prej thirrjve o motër myslimane**  
Kundërshtarët e Islamit dhe të femrës e luftojnë hixhabin me rrugë të shumta dhe një prej tyre është ajo e thirrjve të pavlera dhe fjalët helmuese. Është detyrë që t'u kushtosh kujdes këtyre kurtheve dhe mos u mashtro prej shprehjeve të ndritshme nga jashtë, sepse, ato janë të zbraza në esencë, e as mos u bëj pëlqyese e thirrjeve fallso, mos e pi helmin e përzier me mjaltë, mos e shit veten tënde, fenë tënde dhe nderin tënd armiqëve të Allahut. Bëhu myslimane në thënie dhe në vepër. Largohu prej fesadit, imoralitetit, mosmbulimit, etj ...

Kërkoji mbrojtje Zoti tënd prej parrullave dhe reklamave fallco, të cilat kanë si qëllim shkatarrimin e shoqërisë islame, dhe njollosjen e saj.

Dije mirë se, përparimi është në hixhab, qytetërimi dhe liria ndodhen në Islam dhe në ligjet e tij udhëzuese.

Po ashtu, dije mirë se, poshtërimi, skandali dhe fatkeqësia ndodhen në ligjet kundërshtuese të Islamit dhe njëra prej tyre është mosmbulimi.

**8 - Bëhu thirrëse për hixhabin,** sqarojua filozofinë dhe urtësinë e këtij ligji, të afërmeve të tu, shoqeve të tua... në shkollë, në universitet, në postin administrativ dhe në të gjitha fushat e jetës tënde. Përgjegjësia e predikimit fetar nuk është e veçantë vetëm për meshkujt, apo vetëm për dijetarët por, përkundrazi, ajo është detyrë për të gjithë shoqërinë, siç ka ardhur në një hadith i cili thotë: *“Të gjithë ju jeni përgjegjësa...”*

Në histori përmendet se: Zonja Fatime Zahra u sqaronte grave të Medines çështjet e sheriatit.

Dije mirë se, Allahu (xh.sh) të jep shpërblim të madh për çdo vajzë e cila praktikon ligjin e mbulimit dhe orientohet në rrugën e drejtë prej këshillave të tua.

Në një hadith thuhet: «Allahu i ka thënë Profetit Musa (a.s): *Nëse e orienton një veprues të mëkasteve apo humbës për dënimin Tim, kjo është më e favorshme se 100 vjet ibadet, agjërimi i ditëve të tyre dhe falja në netët e tyre*»<sup>(27)</sup>.

Ajo femër e cila ka qenë e zbuluar, mëkatore, kundërshtuese e ligjeve qiellore, nëse kthehet në zbatimin e hixhabit (*mbulimit*) dhe praktikon detyrat fetare, për shkak të përpjekjeve tuaja dhe këshillave tuaja dashamirëse, ti do të fitosh të njëjtin shpërblim të përmendur në hadithin e lart shënuar.

Pra, për ty është detyrë ta bësh veten tënde misionare të fesë në mesin e femrave të tjera dhe veçanërisht për mbulimin.

#### **9 - Mos e kundërshto martesën**

Kur një person të kërkon që të martohet me ty, interesohu për dy gjëra kryesore, për fenë dhe moralin e tij. Nëse këto dy gjëra ndodhen tek ai person, mos u bëj lëkundëse në pranimin e martesës me të, sepse, feja dhe morali, janë çelësi i lumturisë dhe i harmonisë për jetën tënde. Është detyrë që të pyesësh dhe të interesohesh për këto dy gjëra. Mos pyet për kombësinë e tij, diplomën e tij, pagën e tij dhe për dhuratën (*Mehrin*) që do ta dhurojë ai ty. Mos i kërko ndiesë atij, se do të studiosh, do të marrësh diplomën, e shumë të tjera..

Profeti Muhamed (s.a.s) ka thënë: “*Nëse tek ju vjen një person (kërkon dorën e asaj që është nën kujdestarinë tuaj)*

---

(27) Biharul Envar: V.2. F.4.

*dhe e pëlqeni fenë e tij e edhe moralin e tij martojeni... Nëse nuk veproni do të jetë shkatarrim në tokë»<sup>(28)</sup>.*

Martesa është çerdhe e artë, tek e cila ti gjen qetësinë dhe mbrojtjen prej mëkateve dhe devijimeve morale.

Allahu (xh.sh) nuk e ka krijuar femrën që të jetojë e vetme, por Ai (xh.sh) e ka krijuar atë që të jetojë krah për krah me bashkëshortin, për të themeluar familjen dhe për të ngritur shoqërinë, që në këtë shoqëri, njerëzia të jetë gjithmonë në vazhdimësi, dhe ti të jesh nëna e brezave të ardhshëm.

Nga këtu themi se, vonesa në martesë është gabim dhe rezik, prandaj kujdesohuni për atë.

Profeti Muhamed (s.a.s) ka thënë: «O njerëz! Xhebraili më ka ardhur nga i Dashuri dhe i Gjithdijsmi dhe tha: Vajzat e reja janë të njëjta si frutat mbi pemë.

*Kur piqen dhe nuk këputen, dielli do t'i prishë ato dhe do të kalbëzohen, po ashtu vajzat e reja nëse arrijnë në moshën e pjekurisë, atëherë nuk ka ilaç tjetër për ato përveçse martesës. Nëse nuk e bëjnë këtë ato nuk janë të siguruara prej devijimit, sepse, ato janë njerëz»<sup>(29)</sup>.*

Një burrë u çua dhe i tha Profetit: O i Dërguari i Zotit me kë të martohemi?

Ai (s.a.s) tha: Me të barabartit.

Ai tha: Cilët janë të barabartit?

Profeti (s.a.s) tha: Besimtarët janë të barabartë me njëri - tjetrin.

---

(28) El – Kafi: V.5. F.347.

(29) El – Kafi: V.5. F.337. dhe Biharul Envar: V.103. F. 371.

Në qofëse ai person, i cili kërkon të martohet me ty është jobesimtar dhe mbart morale të këqija, p.sh ai, nuk falet, apo përdor pijet alkolike, e shumë të ngjashme me to, kundërshtojë atë pa dyshime dhe mos të të mashrojë pasuria e tij, posti i tij, sepse, jeta vetjake në këtë rast është më e mirë sesa jetesa me bashkëshort devijues, të pamoralshëm, edhe pse ai është i pasur apo ka post të lartë në shoqëri.

Asnjëherë nuk duhet t`i humbasësh shpresat, por gjithmonë duhet t`i lutesh Allahut me qëllim që të të begatojë me një djalë të ndershëm, besimtar, i cili është bashkues i bukurisë së fytirës, i fesë dhe i moralit. Allahu (xh.sh) thotë: {**Me thirrni Mua, dhe unë ju përgjigjem juve**}<sup>(30)</sup>.



---

(30) Sure Gafir ajeti 60.

## I nderuari bashkëshort

Përgjegjësia jote bashkëshortore është e rrezikshme para Allahut (xh.sh). Ti je përgjegjës për sjelljen dhe veprat e gruas tënde, sepse Allahu të ka bërë përgjegjës për të, ku thotë:

**{Burrat janë përgjegjës për gratë, ngase Allahu ka graduar disa mbi disa të tjerë dhe ngase ata kanë shpenzuar nga pasuria e tyre}**<sup>(31)</sup>.

Allahu (xh.sh) thotë **{O ju bë besuat ruajeni veten tuaj dhe familjen tuaj, prej zjarrit, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...}**<sup>(32)</sup>.

Me qëllim që të kryesh detyrën tënde sipas Sheriatit dhe të plotësosh përgjegjësinë tënde fetare ashtu siç urdhëron Allahu dhe i Dërguari i Tij Muhamedi (s.a.s), është detyrë që ti të praktikosh çështjet dhe mësimet e mëposhtme Islame:

### 1- Së pari hixhabin (*mbulimin*)

Është detyrë që t'a urdhërosh gruan tënde për tu mbuluar nëse është e pa mbuluar, duke i paraqitur asaj të gjitha argumentat bindëse për këtë subjekt, derisa t'a kuptojë këtë ligj të përkryer, pastaj të mbulohet me bindje të plotë.

Nëse nuk je në gjendje t'a bindësh atë, është detyrë e jotja të shkosh sëbashku me të, tek një dijetar i fesë që t'i sqarojë asaj filozofinë e hixhabit dhe rëndësinë e tij, ose t'i japësh asaj literaturë rreth këtij subjekti.

### 2- Largohu festave të përbashkëta

---

(31) Sure Nisa ajeti 34.

(32) Sure Tahrir ajeti 6.

Mos shko me gruan në festa dhe në vende të tjera tek të cilat meshkujt dhe femrat festojnë sëbashku. Largoje gruan tënde prej ambienteve të muzikës devijuese, kërcimeve etj, sepse, këto vende ndoshta njollosin moralin e saj dhe do të sjellin rreziqe për nderin e saj.

Ai bashkëshort, i cili e fton gruan e tij në mosmbulim, në kinema, në festat muzikore, ky konsiderohet tradhëtari i parë i saj dhe ai do të jetë i pari kriminel për të drejtat e saj, sepse, ai e fton gruan e tij për në fesad, e udhëheq atë për në devijim dhe e drejton atë për nga poshtërsirat.

Ai bashkëshort, do të jetë i pari i cili do të paguajë taksin e veprimit të tij dhe do të shikojë shpërblimin e veprës kur gruaja e tij do ta tradhëtojë, do të bëhet e pa bindur dhe kur do të lidhë mardhënie ilegale me të tjerët.

Prandaj, është obligim për ty, o bashkëshort i nderuar, që të largohesh prej të gjitha atyre vendeve të papëlqyera dhe imorale, me qëllim që të jetosh, i qetë, i bindur, i sigurtë dhe të fitosh begatitë e Allahut në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

### **3- Mos i'u përul gruas tënde në mëkate**

Është detyrë që ti sëbashku me familjen tënde të jetoni siç i'u urdhëron Allahu Fuqiptotë, të zbatoni rregullat e Tij dhe të jeni të kujdeshëm prej çdo devijimi dhe degjenerimi.

Ka raste që gruaja, të kërkon ty ato gjëra të cilat janë të papëlqyeshme dhe urryese tek Allahu, për këtë është obligim për ty që t'ia shpjegosh asaj atë subjekt, t'ia ndërrosh asaj mendimin dhe mos i'u përul në mëkatet e Allahut, sepse, «Nuk ka përulje për të krijuarin në mëkatet e Allahut».

Profeti Muhamed (s.a.s) ka thënë: «Ai cili i përulet gruas së tij, Allahu do ta hedhë atë person në zjarr.

Atij i thanë : *Cila është ajo përulje?*

Ai i`u përgjigj: *Të kërkojë prej tij që të shkoj s në vendet e notit (kur në të ndodhen edhe meshkuj), në dasma dhe rroba të tejdukshme»<sup>(33)</sup>.*

#### **4- Mësoji asaj suren Nurë**

I nderuar bashkëshort, duhet t`ia mësosh gruas tënde suren "Nurë" sëbashku me komentimin e saj, sepse, kjo sure përmban ajete të cilat kanë lidhje me femrën dhe ajo duhet t`i dijë ato, me qëllim që të jetojë në këtë jetë e pastër dhe larg prej të papëlqyerave. Profet Muhamedi (s.a.s) ka thënë: «*Mësojani grave suren Nurë, sepse, ajo përmban këshilla të vyera»<sup>(34)</sup>.*

Është për të të ardhur keq, që në këto ditë, shoqëritë të jetojnë të paditura për këto mësimë të përsosura islame.

Prandaj, është obligim i yti o i nderuar bashkëshort që të kujdesesh për këto mësimë islame dhe t`i zbatosh ato në jetën tënde familjare e bashkëshortore, që të jetosh ti sëbashku me familjen tënde të larguar nga skandalet e dynjasë dhe dënimit e Ahiretit (*botës tjetër*).

### **Mësimë Islame**

I dashur vëlla musliman, për ty po përmendim disa mësimë Islame, të cilat kanë si qëllim mbrojtjen e njeriut dhe të

---

(33 ) El-Kafi V.5. F.517.

( 34) El – Kafi: V.5 F.516.

shoqërisë prej degjenerimit dhe asgjësimit. Këto mësimë janë si vijon:

## 1- Mos i shiko femrat e tjera

Shikimi i femrave të panjohura konsiderohet si faktori i parë që ndikon në devijimet morale. Ky veprim është çelësi i sherrit (*këqijave*) dhe shkaktari i rrëshqitjes për në humnerën e devijimit, sepse, shikimi i parë e tërheq njeriun në shikimin e dytë, të tretë... e së fundi e çon atë në fëlliqësira...

Një poet thotë:

Shikimi, buzëqeshja dhe përshëndetja, pastaj fjalët, vendtakimi dhe... përfundimi.

Allahu (xh.sh) e ka bërë haram shikimin e grave dhe i paralajmëron besimtarët që të mënjanojnë sytë e tyre prej këtij veprimi. Allahu (xh.sh) në Kur'an thotë: **{Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet prej haramit dhe të ruajnë pjesët e turpshme të tyre se kjo është më e pastër për ta dhe se Allahu është i Dijshëm për ato gjëra që ata veprojnë}**<sup>(35)</sup>.

Është e natyrshme, se nëse dy gjinitë (*burrë-grua*) shikojnë njëri-tjetrin do të ndodhë preferencë në mes tyre. Prandaj, duhet që shikimi të jetë i kufizuar me kufijtë e Sheriatit Islam se përndryshe rezultatet do të jenë të këqia dhe pasojat të rënda.

Imam Sadiku ka thënë: «*Shikimi i njëpasnjëshëm mbjell epshe në zemra dhe sjell shkatarrim*»<sup>(36)</sup>.

---

(35) Sure Nur ajeti 30.

(36) El – Alai Ahbar 2-5 F. 196.



Shikimi haram (*i ndaluar*) është parapërgatitje për veprat e ndyta. Për këtë në një hadith thuhet: «*Shikimi është posta e zinasë (prostitucion)*» pra, kryerja e zinasë vjen prej shikimit haram.

Dihet se, zinaja, nuk ndodh vetëm e vetëm pas shikimit të mashkullit tek femra dhe dëshira e tij për të, prandaj, shikimi haram është ftesë për në zina.

Gjithashtu, mos pyet për ndikimet e këqija të zinasë «*prostucionit*» siç janë, sëmundjet vdekje prurëse dhe shkatarrim i shoqërisë.

Çelësi i të gjitha këtyre fatkeqësive është shikimi tek gratë e huaja.

Profetin Jahja e pyeti ibën Zekeria rreth fillimit të zinasë?

Ai tha: «*Shkikimi dhe muzika*».

Nuk është çudi, kur shikon rreptësinë e Sheriati për këtë çështje, sepe dënimi në ahiret do të jetë më i ashpër dhe më i dhimbshëm.

Në një hadith thuhet: «*Kush i mbush sytë e tij duke shikuar një femër me shikim haram, Allahu do t`i mbushi sytë e tij në Ditën e Gjykimit me gozhda prej zjarri dhe do t`ia mbulojë me zjarr, deri sa ti gjykoji të gjithë njerëzit pastaj jep urdhër që ky person të hidhet në zjarr*»<sup>(37)</sup>.

Në një tjetër hadith thuhet : «*Kush i mbush sytë e tij me shikim haram, Allahu do t`i mbushë sytë e tij me zjarr në Ditën e Gjykimit, me përjashtim nëse ai person pendohet*»<sup>(38)</sup>.

---

(37) Ikabul Amal, i Sudukit.

(38) Alail Ahbar V.5. F.159.

Prej ndikimeve negative që shkakton shikimi në drejtim të femrave, është vuajta shpirtërore dhe mendore.

Imam Aliu (r.a) thotë : «*Kush shikon femrat, shtohen vuajtjet e tij*»<sup>(39)</sup>.

Po ashtu, ai thotë : «*Nëse shikimet janë të vazhdueshme, vuajtjet janë të qëndrueshme*»<sup>(40)</sup>.

Ai njeri i cili i zgjeron shikimet e tij, duke shikur ku dëshiron dhe çfarë dëshiron, vuajtjet e tij do të jenë të shumta. Ai do të jetojë i pikëlluar në vetvete dhe i mërzhitur në mendime, sepse, ndoshta zemra e tij është lidhur me një prej atyre shikimeve. Për këtë qëllim, ai do të mendojë së tepërmi duke mos fjetur natën e as nuk qetësohet ditën.

Imam Sadiku ka thënë : “*Shikimi është shigjetë prej shigjetave të helmuara të shejtanit (djallit). Sa të shumta janë ato shikime që trashëgojnë vuajtje të gjata*”<sup>(41)</sup>.

A e ke parë shigjetën se si hyn në trup dhe ajo i shpon damarët dhe qelizat nervore?!

Kjo ndodh nëse nuk është e helmuar, sepse, nëse është e helmuar vuajtjet do të jenë më të shumta dhe njeriu humbet jetën e tij!!

Po kështu, është shikimi në drejtim të femrave të huaja. Ai shikim është shigjetë helmuese e cila hap rrugën e saj për në zemër dhe zhvesh prej saj qetësinë duke lënë vuajtje dhe pikëllime të gjata!!! ( Ah, sikur të kuptohet!)

---

( 39) El – Kafi: V.8.

( 40) Xhamiul Ahbar F.93.

(41 ) Biharul Anvar: V.104. F.40.

I dashur vëlla besimtar, që të jesh sa më tepër i pastër, i begatë, i larguar prej veprimeve të djallit, Islami e ka bërë të përlqyeshëm për ty që të shikosh femrat nga pas.

Ti shikon shumë të pamoralshëm të cilët i shikojnë femrat drejt për së drejti dhe kur ajo largohet prej tyre ata e shohin atë nga pas duke vështuar me vëmendje lëvizjet e saj dhe madhësinë e trupit të saj.

Ebu Basir e pyeti Imam Sadikun: “Çfarë na thua për një grua e cila kalon pranë një burri dhe ai e shikon atë nga pas?”

Ai i tha: *A i pëlqen ndonjërit prej jush që të tjerët të shohin familjet tuaja dhe të afërmet tuaja?*

Ai tha: *Jo.*

Ai tha: *Pëlqe për njerëzit ato që pëlqen për veten tënde*”<sup>(42)</sup>.

Në Kur'an përmendet një rast i shkëlqyer i Profetit Musa (a.s) me vajzat e Shuajbit (a.s). Ajeti thotë: {**O babai im merre këtë në shërbim me pagë sepse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishmi dhe besniku**}<sup>(43)</sup>. Shuajibi i tha vajzës së tij: *Ti thua, se ky (Musai) është i fortë dhe ti e shikove kur Ai ngrinte gurët e mëdhenj.*

*Si e njohe se ai është besnik?*

*Ajo i tha: O baba unë ecja para tij dhe ai më tha: Ec pas meje, nëse unë e humb rrugën ti më udhëzo. Ne jemi prej atyre që nuk i shohin nga pas gratë* »<sup>(44)</sup>.

---

(42) Alail Ahbar: V.5. F.196.

(43) Sure Kasas ajeti 26.

(44) Alail Ahbar: V.5. F.196.

Rreth komentimit të thënies së Allahut (xh.sh): «**U thuj besimtarëve që t`i ndalin shikimet e tyre.**<sup>(45)</sup>» Imam Bakiri ka thënë: «Një djalë prej ensarëve (përkrahësve) shikoi një grua nga Medina derisa ajo u afrua tek ai. Kur ajo u largua prej tij, ai e shikonte atë grua nga pas. Ajo hyri në një rrugicë të ngushtë dhe ai nuk i largoi sytë prej saj derisa u përplas me murin dhe u gërvisht në fytyrë.

*Kur ajo gruaja u largua, djali vështroi gjak mbi rrobat e tij. Ai tha: Pasha Allahun, unë do të shkoj tek Profeti Muhamed dhe do ta lajmëroj rreth asaj që më ndodhi.*

*Kur Profeti e pa i tha atij: Ç'është kjo?*

*Djali e lajmëroi se çfarë ndodhi dhe në ato momente zbriti Xhebraili me këtë ajet:*

**{U thuj besimtarëve t`i ndalin shikimet e tyre}**<sup>(46)</sup>.

Në një hadith thuhet: «Mos bëni zina, sepse edhe gratë tuaja do të bëjnë zina».

*Tregohet se një person shiste ujë prej tridhjetë vjetësh, në shtëpinë e një argjendari. Nganjëherë argjendari nuk ndodhej në shtëpi dhe gruaja e tij i`a hapte derën shitësit të ujit që të zbrazte ujin në vendin e caktuar. Gjatë gjithë kësaj kohe, shitësi i ujit nuk bëri asnjë tradhëti në drejtim të gruas së argjendarit, qoftë edhe një shikim të vetëm haram.*

*Në një ditë prej ditëve, kur gruaja e argjendarit hapi derën shitësi i ujit i kapi asaj dorën dhe i`a puthi!*

*Gruaja e argjendarit e tërhoqi dorën me sa fuqi që kishte duke i bërtitur në fytyrë dhe e përzuri nga shtëpia.*

---

(45) Sure Nur ajeti 26.

(46) Sure Nur ajeti 26.

*Pastaj, ajo e habitur, filloi të mendojë rreth këtij veprimi tradhëtues, të cilin e veproi shitësi i ujit pas asaj sigurie dhe besimi për tridhjetë vjetëshs!!?*

*Kur argjendari u kthye në shtëpi ajo e pyeti se çfarë kishte bërë në treg këtë ditë?*

*Ai i tha : Një grua erdhi për të blerë byrzylykë floriri. Kur ajo e zbuloi dorën për të provuar byrzylykun unë i`a kapa dorën dhe e putha !!*

*Gruaja e tij bërtiti: Allahu Ekber! Pastaj i tregoi atij se çfarë i ndodhi asaj me shitësin e ujit»<sup>(47)</sup>.*

S'ka dyshim se çdo veprim që një person do të veprojë në drejtim të nderit të tjerëve dhe grave të tyre, po ashtu do t'i veprohet atij në drejtim të gruas, nënës, motrës së tij. (Prandaj kujdesohuni!)

Në një hadith hyjnor thuhet: «Si do të veprosh do të të veprohet edhe ty».

Lexues i dashur, po kthehemi në bisedën rreth shkimit të femrave të huaja dhe themi se, Islami është fe e dashurisë dhe e dashamirësisë, fe e kurajos dhe e kujdesit, për këtë në Kur'an, kur Allahu përmend xhennetin (parajsën) dhe mirësitë e tij, menjëherë përmend xhehennemin (skëterrën) dhe vuajtjet e tij, po ashtu e kundërta, kjo, me qëllim që njeriu të arrijë në dëshirën për xhennetin dhe t'i frikësohet xhehennemit dhe dënimit të tij.

Pak më lart, ti lexove disa hadithe që flasin rreth dënimit dhe ndikimeve negative nëse shikon femrat e huaj.

Tani erdhi radha e haditheve që flasin rreth shpërblimit të kënaqshëm, të cilin Allahu (xh.sh) i`a premtton atij personi që i largohet këtij harami dhe për ndikimet pozitive të tij.

Profeti Muhamed (s.a.s) ka thënë:«Shkimi në bukuritë e femrave është shigjetë prej shigjetave të djallit. Ai që i

---

(47 ) Alail Ahbar: V.5.

*shmanget, Allahu do t`ia provojë atij shijen e imanit i cili e begaton atë»<sup>(48)</sup>.*

Ai (s.a.s) ka thënë:«*Shikimi është shigjetë e helmuar prej shigjetave të djallit. Ai i cili i shmanget atij prej frikës së Allahut, Allahu do t`i japë atij atë besim ku ëmbëlsinë e tij do t`a gjejë në zemrën e tij:»<sup>(49)</sup>.*

Po ashtu Ai (s.a.s) ka thënë:«*Ndalojini shikimet tuaja (ato që janë haram) të shihni çudira»*, sepse, Allahu (xh.sh) thotë: **{I thuaj besimtarëve ti ndalojnë shikimet e tyre}**<sup>(50)</sup>.

Ti thua: Cilat janë ato çudira?

Nuk ka dyshim se, Allahu (xh.sh) e ka rrethuar njeriun me bereqete dhe begati ku ai vetë çuditet prej tyre, por ai nuk është i aftë ti kuptojë ato. Po ashtu, nëse njeriu dëshiron ti sprovtojë ato bereqete dhe begati të Allahut, duhet që të zbatojë rregullat dhe ligjet e Tij (xh.sh), sepse në zbatimin e tyre ndodhen bereqete e mirësi. Ndër ato rregulla, është që të mos shikojë femrat e huaja.

Imam Sadiku ka thënë: «*Asnjë nuk është i pa mëkat, ashtu siç është ai që i ndalon shikimet, sepse para se të ndaloi shikimin nga haramet e Allahut, në zemrën e tij ndodhet fama dhe madhështia»<sup>(51)</sup>.*

Tani ka mbetur pyetja e fundit e cila është: Si të largohet njeriu nga ky haram ku dihet se “*kanceri*” i mosmbulimit të grave dhe se mbulimi jo i plotë po pakësohet.(*Është për të të ardhur keq se mos mbulimi ndodhet edhe në vendet islame*)?!

A duhet që njeriu të mbylli sytë?

Si do ta shohë rrugën e ai?

Përgjigje: Më lart lexove se në disa ajete dhe hadithe kërkohet ndalimi i shikimit dhe jo mbyllja e syve.

---

(48 ) Mustedrekul Vesail: V.2. F.554.

(49 ) Biharul Anvar: V.104 F.42.

(50 ) Sure Nurw – 26.

(51 ) Biharul Anvar V.104. F.41.

Kur një mashkull sheh një femër, ai duhet që menjëherë të shikoi në tokë ose të shikoi nga ana tjetër, sepse Allahu nuk i'a humb atij shpërblimin e veprave që janë të pëlqyera tek Ai (xh.sh).

## **2- Mos u`a jep dorën femrave të huaja**

Allahu (xh.sh) e ka bërë haram (të ndaluar) për ty, i dashur vëlla musliman, që të takosh me dorë femrat, me përjashtim të atyre që të është lejuar t'i takosh ato. Profeti Muhamed (s.a.s) ka thënë: *Kush e takon një grua duke i dhënë dorën ajo i bëhet haram atij (për martesë ) dhe Allahu është i zemëruar prej Tij.*

*Kush takohet me një femër të huaj dhe i jep dorën, s ai do të hyjë në zjarr me djallin<sup>(52)</sup>.*

## **3- Mos bëj shaka me femrat e huaja.**

Vëlla musliman, prej atyre që Allahu ta ka ndaluar ty veprimin e saj, është shakaja me femrat e huaja, sepse, ky veprim në të shumtën e rasteve të çon në devijim dhe në ndikimin e epsheve që ndodhen tek të dy palët.

Profeti Muhamed (s.a.s) ka thënë: *“Kush bën shaka me një grua ajo i bëhet haram atij (të martohet me të). Allahu do ta burgosi për çdo fjalë që tha, një mijë vjet (në Ditën e Gjykimit)<sup>(53)</sup>.*

## **4- Mos e vono martesën**

---

(52 ) Biharul Anvar V.104.

(53 Amal i Sudukut.

Vëlla musliman, martesë është mjaft e domosdoshme. Kur njeriu të plotësojë moshën e pjekurisë, ai duhet të martohet, sepse me anë të martesës, ai plotëson fenë e tij, fiton begatinë e Allahut dhe mbron veten e tij prej mardhënieve të ndyta seksuale.

Allahu (xh.sh) ka vendosur për njeriun epshet seksuale të cilat janë mjaft të forta. Këto epshë kanë si qëllim vazhdimësinë e qënies njerëzore nëpër shekuj.

Për përmbushjen e këtyre epshëve, Allahu ka vendosur martesën, me anë të së cilës mardhëniet seksuale janë të lejueshme.

Vonesa në martesë e çon njeriun në dy gjëra.

1) Në bllokimin e epshëve të tij, presioni shpirtëror si dhe përballimin e vuajtjeve.

2) Në veprimin e harameve duke u strehuar tek eksitimi me mënyra të ndryshme, ose në mardhëniet e fëlliqura e të ndyta seksuale apo homoseksuale (mashkull me mashkull) ose kryerjen e zinasë e cila është shkatërruese e nderëve.

Dihet qartë se, të dyja këto gjërat e lartpërmendura janë të rrezikshme për njeriun dhe për nderin e tij, sepse bllokimi dhe presionet janë shkaqe të sëmundjeve nervoze, të moralit të keq dhe të vuajtjeve shpirtërore.

Ndërsa, kryerja e të ndaluarave (*haram*) e çojnë njeriun në veprimin e krimeve në humbjen e nderit e të fisnikërisë dhe do të përfundojë në gjykata e pastaj në burg në të cilin do të jetojë me hajdutët dhe kriminelët! Pa llogarit dënimin në botën tjetër...

Cila është rrugëzgjdhja?



Rrugëzgjdhja të cilën e ka vendosur Islami është martesë të cilën e mbështet edhe llogjika e shëndoshë. S`ka dyshim se martesë është ilaçi i vetëm për këtë çështje, sepse martesë i sjell njeriut lumturi, qetësi shpirtërore, moral të përsosur, aktivizim dhe kënaqësi.

Në të njëjtën kohë, martesë e bën njeriun t`i largohet haramit (të ndaluara) dhe e shmang atë prej të papëlqyerave dhe ndytësive.

Këtu shtojmë se, Allahu (xh.sh) nuk e ka krijuar njeriun që ai të jetojë beqar dhe i vetmuar, por Ai e ka krijuar atë me qëllim që të jetojë krah për krah me bashkëshorten e tij të zgjedhur, të krijojë familje, shoqëri dhe të edukojnë fëmijët me edukatë të pëlqyeshme të bazuar mbi moralet e përsosura.

Beqaria është e përbuzur tek Allahu (xh.sh), e kundërshtuar në Islam dhe e papëlqyer tek evlijatë e Zotit (xh.sh).

Profeti Muhamed (s.a.s) ka thënë: «*Të këqijtë tuaj, janë beqartë tuaj*» «*Beqarët janë vëllezërit e djallit*»<sup>(54)</sup>.

Po ashtu Ai (s.a.s) ka thënë: «*Shumica e banorëve të xhehennemit janë beqarët*».

Ak-Kaf El Hilalij ka thënë: *Një ditë shkova tek Profeti dhe Ai më pyeti: O Ak-kaf a je i martuar?*

I thashë: *Jo.*

Ai (s.a.s) më tha: *A ke mundësi financiare dhe fuqi trupore për martesë?*

Unë i thashë: *Po, dhe falenderoj Zotin.*

Profeti (s.a.s) më tha: *Ti je prej vëllezërve të djallit. Ose të jesh prej priftërinjëve, ose të veprosh siç veprojnë muslimanët sepse prej synetit tonë është martesë. Derisa tha:*

---

(54) El- Vesailu: V.7. F.6.

*I mjeri ti o Akaf, martohu... martohu... sepse ti je prej gjynahqarëve.*

Unë i thashë: *O i dërguari i Allahut më marto para se të çohem dhe Profeti e martoi atë*<sup>(55)</sup>

Përsa i përket kurajos dhe nxitjes për martesë Profeti Muhamed (s.a.s) ka thënë: *“Në islam nuk ka veprim më të dashur dhe më të pëlqyer se sa është martesë”*<sup>(2)</sup>.

Po ashtu Ai ka thënë: *«Ai mashkull i cili martohet në moshë të re ai është zemëruer i djallit i cili thotë, o i mjeri unë, ky person ka mbrojtje nga feja e tij prej meje»*. Pastaj Profeti tha : *Ti frikësohet Allahut në pjesën e mbetur*<sup>(56)</sup>.

Ky hadith është argumentues për domosdoshmërinë e martesës dhe ndikimet që sjell në jetën e njeriut.

Këtu po i përfundojmë thëniet rreth martesës me një hadith të Profetit Muhamed (s.a.s) i cili ka thënë:

*«Dy reqate namaz të cilat i fal i martuari janë më të favorshme se shtatëdhjetë reqate që i fal beqari»*<sup>(57)</sup>.

---

(55- 2 ) Mustedrekul Vesail Kapitulli i martesës.

(56) Mustedrekul Vesail: Kapitulli i martesës.

(57) El- Vesailu: V.7 F.8

## E ardhmja e gruas së zbuluar

Cili do të jetë përfundimi i gruas së zbuluar në ahiret (*botën tjetër*)?

Ne e dimë, se Allahu (xh.sh) u ka premtuar dënime të rënda të gjithë atyre që i kundërshtojnë urdhërat e Tij, veprojnë haramet (*të ndaluarat*) dhe nuk zbatojnë vaxhibet (*të urdhëruarat*). Cili do të jetë ai dënim që do të ketë gruaja e pa mbuluar në Ahiret?

Cili do të jetë ai dënim që Allahu e ka caktuar për femrën që nuk e zbaton hixhabin dhe zgjedh zbulimin?

**Përgjigje:** Zbulimi i sjell femrës mallkim dhe e largon atë nga rahmeti (*mëshira*) e Zotit dhe begatitë e Tij si dhe e çon atë drejt dënimit.

Profeti Muhamed (s.a.s) ka thënë: «*Në fundin e zëmanit do të ketën burra prej ymetit tim, gratë e të cilëve do të jenë të pa mbuluara, flokët i lidhin në mesin e kokës dhe u`a shfaqin meshkujve. Mallkojini ato, sepse, ato janë të mallkuara dhe nuk do t`a shijojnë aromën e xhennetit*»<sup>(58)</sup>.

Imam Aliu ka thënë: *Në fundin e zëmanit dhe në afërsi të kijametit (ky do të jetë zamani më i ligë) do të shfaqen femra të zbukuruar, të dala nga feja, të futura në ligësira, të devijuara kah epshet, të shpejtuara për tek qejfet, hallallin e bëjnë haram, haramin e bëjnë hallall, në xhehennem do të qëndrojnë për gjithmonë*».

Po ashtu, ndodhet hadith nga Profeti (s.a.s) i cili tregon për dënimin e grave të zbuluara në Ahiret.

---

(58) Musnedi i Ahmedit, hajatul hajvan i Demrij.

Po shkëpusim prej tij këto paragrafe:

Imam Aliu (r.a) ka thënë: *Një ditë unë dhe Fatimeja shkua tek Profeti Muhamed (s.a.s) dhe e gjetëm atë me sy të përlotur. Unë i thashë: Kurban për ty nëna ime dhe babai im, pse po qan?*

*Ai tha: O Ali, natën e miraxhit unë pashë gratë e ymetit tim në tortura të ashpëra. Më erdhi keq kur pashë gjëndjen e tyre dhe qave prej torturave të dhimbshme. Pastaj, Profeti filloi të tregojë se çfarë kishte parë në natën e miraxhit duke thënë: Unë pashë një grua të varur nga flokët e saj dhe truri i saj po valonte. Pashë një grua të varur prej gjuhës së saj dhe uji i nxehtë i xhehennemit hidhej në fytin e saj. Pashë një grua e cila po hante mishin e trupit të saj dhe zjarri ishte i ndezur poshtë saj. Pashë një grua ku këmbët e saj ishin të lidhura me duart e saj dhe e kishin sulmuar gjarpërinjtë dhe akrepat. Pashë një grua të shurdhët, të verbët, memece në arkivolin prej zjarri dhe mishi i kokës po i dilte nga hundët, trupi i saj ishte i copëtuar prej hixhamit (ilaç i cili shkakton thërrmimin e mishit) dhe bursit (ilaç i cili shkakton kruajtjen dhe rënien e mishit). Pashë një grua e cila po priste mishin e trupit të saj me gërshërë..*

Zonja Fatime Zahra (r.a) i tha babait të saj: *Më trego çfarë veprash kishin kryer ato gra në dunja, derisa Allahu u caktoi atyre këto dënime?*

*Ai (s.a.s) tha: Përsa i pëket gruas që ishte e varur prej flokëve të saj, ajo në dunja u`a shfaqte burrave flokët e saj.*

*Përsa i pëket gruas së varur nga gjuha e saj, ajo shante dhe poshtëronte burrin e saj.*

*Përsa i pëket asaj që po hante mishin e trupit të saj, ajo e zbukuronte trupin e saj për njerëzit.*

*Përsa i përket asaj që duart i ishin lidhur me këmbët dhe e kishin sulmuar gjarpërinjtë dhe akrepat, ajo ka qenë e pa pastër, nuk merrte abdes, nuk i pastronte rrobat, nuk lahej prej xhynybit dhe menstruacionit, nuk pastronte veten e saj dhe namazin e quante gjë të pa vlerë.*

*Përsa i përket verbueses, shurdhes, memeces, ajo lindte fëmijë me zina dhe thonte se këto janë fëmijët e burrit të saj.*

*Përsa i përket asaj që po priste mishin e saj me gërshërë ajo ekspozonte veten e saj për meshkujt... deri në fund të hadithit»<sup>(59)</sup>.*

Në këtë hadith ne na sqarohen llojet e dënimit që Allahu (xh.sh) e ka caktuar për gratë e zbuluara dhe kjo ka kuptimin, se çdo grua e pambuluar patjetër dhe pa dyshim do ta provojë këtë dënim të dhimbshëm dhe lëndues, me përjashtim nëse ajo pendohet tek Allahu (xh.sh) për atë gjendje që ka qenë më parë dhe vesh hixhabin e urdhëruar prej Allahut. Zoti Fuqiptotë e pranon pendimin e saj dhe i'a fal asaj mëkatet.

Allahu (xh.sh) në Kur'an thotë: **{Ai është që pranon pendimin e robërve të vet dhe shlyen të këqiat dhe e di çka punoni}**<sup>(60)</sup>.

Po ashtu thotë: **{Nuk ka dyshim, Unë e fal atë që është penduar dhe beson e vepron vepra të mira dhe përqendrohet për në rrugën e drejtë}**<sup>(61)</sup>.

Sadekall-llahul adhim.

---

(59) Biharul Anvar: V.103. F.245.

(60) Sure Shura – 25.

(61) Suretu Taha – 82.

## Fjalët e Fundit

Në të gjitha ato që përmendëm u qartësua se hixhabi (*mbulimi*) është ligj i përsosur i cili merr përsipër lumturinë e gruas, pastërtinë e familjes dhe shoqërisë. Ai është ligji i Sheriatit të cilin e ka caktuar Allahu (xh.sh) në Kur'anin Kerim dhe e dëshmon Profeti (s.a.s) familja e tij e pastër dhe e nderhme si dhe shokët e tij të zgjedhur (r.a).

Po ashtu na u bë e qartë se zbulimi është shkaktari i fatkeqësive për femrat, shkatarrim i gjendjes shpirtërore në familjes dhe çrregullim për shoqërinë. Në shtesë të këtyre ai (zbulimi) është kundërshtim i urdhërave të Allahut (xh.sh).

Prandaj, është detyra e jona në pëgjithësi që të sakrifikojmë për zbatimin dhe përhapjen e këtij ligji hynor në mesin e femrave, qoftë në shtëpi, në shkollë, në universitete e në të gjitha fushat, sepse, në zbatimin dhe përhapjen e këtij ligji ndodhen shpërblime dhe mirësi për të dyja botët! (*Dynjanë dhe Ahiretin*).

*Fladi*

## Përmbajtja e librit

Parathënie.....	3
Kurani është vërtetues hixhabit.....	7
Fatime Zahra.....	13
Çfarë është e mirë për gruan.....	14
Dialogu i shkëlqyer.....	15
Në Xhaminë e Profetit.....	16
Virtyti është bukuri për gruan.....	17
Dialog me vajzën krishtere.....	19
Dallimi në mes gruas së mbuluar dhe asaj të zbulua.....	21
Çfarë qëllimi kanë thirrësit në zbulim.....	23
Cila është më e përsosura.....	26
Mosmbulimi, kolera e shoqërisë.....	28
Mosmbulimi është shkatarrim.....	29
Mosmbulimi dhe krimet e përdhunimit.....	31
Mosmbulimi dhe krimet e abortit.....	34
Mosmbulimi dhe tradhëtia bashkëshortore.....	35
Roli i kinemave në drejtim të mos mbulimit dhe shkatarrimit.....	41
Mikrobi i përzierjes.....	43
Islami nuk është fe e mendimeve.....	45
Çfarë vërtetuan thirrësit për mos mbulim.....	48
O Motër muslimane.....	50
1- Hixhabi (mbulimi) para çdo gjëje.....	50
2 - <i>Mos përdor makiazhe, bizhuteri dhe parfumëra</i> .....	52
3- Mos u bëj e ngjashme me burrat.....	53
4 - Mos i tako burrat e panjohur me dorë.....	53

5 - Mos u bëj e turpshme prej mbulimit.....	54
6 - Besimi në vetvete nuk është i mjaftueshë...	56
7 - Mos u mashtro prej thirrjeveve o motër myslimane.....	57
8 -Bëhu thirrëse për hixhabin.....	58
9 - Mos e kundërshto martesën.....	59
I nderuar bashkëshort.....	62
1 - Së pari hixhabin (mbulimin).....	62
2 - Largohu festave të përbashkëta.....	63
3 - Mos i'u përul gruas tënde në mëkate.....	63
4 - Mësoji asaj suretin Nur.....	64
Mësime Islame.....	65
1 - Mos i shiko femrat e tjera.....	65
2 - Mos u'a jep dorën femrave të huaja.....	72
3 - Mos bëj shaka me femrat e huaja.....	73
4 - Mos u vono për martesë.....	73
E ardhmja e gruas së zbuluar.....	77
Fjalët e Fundit.....	81



*Shogata*  
*Fladi*